

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7412 E mërkurë 17 Janar 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion Ditës

Nga BATON HAXHIU



Vrasja e Oliver Ivanoviçit, shenjë e frymës së ndarjes

Ç'të thuhet për këtë vrasje? Krejt kjo situatë, përfshirë edhe vrasjen e Oliver Ivanoviçit, po fshin gjithçka që është arritur në Kosovë. Oliverin e kam njohur ...
Vijon në faqen 20

Opinion Ditës

Nga REXHEP QOSJA



Për një këshill mbarëkombëtar për Vitin e Skënderbeut

Qeveria e Shqipërisë e ka shpallur vitin 2018 Vit të Skënderbeut. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka propozuar themelimin e një komisioni ...
Vijon në faqen 21



Pranga policit privat, një tjetër ndiqet në gjendje të lirë

Grabitja e bankës të Hipoteka, dëshmitarët: I vuri pistoletën në kokë punonjëses

Kamerat regjistruan personin që sulmoi, ndërtohet identikiti i tij

Nga INA ALLKANJARI

Zbardhet dinamika e grabitjes me armë zjarri të ndodhur mesditën e së hënës në orën 14:00 në një bankë të nivelit të dytë brenda ambienteve të Hipotekës në kryeqytet. Gjithçka ndodhi në vetëm pak sekonda. Një person ...
Ne faqet 2-3

FLET KRYETARI I SHOQATËS ANTIKOMUNISTE TE TE PERNDJEKURVE POLITIKE

ISH-TE PERNDJEKURIT, U HIQET DEMSHPERBLIMI 300 MIJE VETAVE

Nebil Çika: Ndryshimet në ligj, trashëgimtarët rrezikojnë të humbasin të drejtën. Rikthim në luftën e klasave. Kreu i PD, Basha: Akt i papranueshëm



(Në foto) Ish-të përndjekur në protestë. Kryetari i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politike, Nebil Çika

'RAPORTI ME RAMEN E RUÇIN'

Ilir Meta: Koha për një dialog strukturor, për çeljen e negociatave

Ne faqen 7

DESHMIA NE GJYQ

Gilmano Dani: Ylvi Beqjan ma prezantoi Shullazi në shtëpinë e tij, çfarë më tha

Ne faqen 10

ZHBEHET SUKSESI

Peshëngritja mbulohet nga turpi, Romela sërisht me doping, federata hesht

Ne faqen 22

'VIP PAGES'

Xhensila Pere: Do të vija me skena erotike në një film, çunat si karta krediti

Suplement

Aplikoni nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë"

416 vende të lira pune në mjekësi, lista e plotë

Ministria e Shëndetësisë: Udhëzimi, dokumentacioni që duhet të dorëzoni

Nga VOLTJA DURO

Deri më datën 1 shkurt të këtij viti, të gjithë të interesuarit që përmbushin kriteret mund të aplikojnë për pozicionet e lira të punës në disa prej degëve të mjekësisë. Respektivisht, janë 416 vende vakante në



infermieri/ mami, fizioterapi/ logopedi dhe teknik imazherie apo laborator. Sot, në "Gazeta Shqiptare" publikohet numri i pozicioneve të lira në secilën degë në bazë garku. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bën ...
Ne faqen 12

HARADINAJ: AGJENTE TE FBI PER T'I ZBULUAR



Vritet lideri serb në Mitrovicë, Oliver Ivanoviç. Gruaja: E di kush e ka vrarë

Ne faqen 17

GRABITJA E BANKES HETIMET

Dyshime se autori ka marrë një shumë prej rreth 500 mijë lekësh

Grabitja e bankës të Hipoteka, kamerat regjistruan personin që sulmoi Zbardhet ngjarja, ja si ndodhi vjedhja

Zbardhet dinamika e grabitjes me armë zjarri të ndodhur mesditën e së hënës në orën 14:00 në një bankë të nivelit të dytë brenda ambienteve të Hipotekës në kryeqytet. Gjithçka ndodhi në vetëm pak sekonda. Një person i maskuar dhe nën kërcënimin e pistoletës mori paratë e arkës. Sipas burimeve grabitësi ka pasur edhe një bashkëpunëtor i cili po e priste jashtë godinës. Autori i ngjarjes, i cili dyshohet të jetë një i ri rreth moshës 25 vjeç, ka përdorur një kapele në kokë për të fshehur identitetin. Mësohet se në brez ka pasur një armë zjarri tip pistoletë. Në momentin kur ka hyrë në ambientet e bankës, bëhet me dije se grabitësi nën kërcënimin e pistoletës, fillimisht kanosi policin privat duke e mënjeluar tek muri dhe më pas i ka kërkuar punonjësve të bankës të mos lëvizin nga vendi. Më pas ai i është drejtuar sportelit të bankës private ku u ka drejtuar armën arkëtareve. Mësohet se autori i grabitjes ka kanosur me armë arkëtare duke i kërkuar lekët përndryshe do ta vrasë. Arkëtarja për disa sekonda ka hezituar dhe nuk ka bërë asnjë veprim. Në këtë moment grabitësi me qytën e armës ka qëlluar xhamin e bankës, i cili ka pësuar plasaritje. E trembur arkëtarja ka hapur kasafortën e arkës dhe i ka futur në një gese të zeze mbeturinash të gjitha paratë. Nga aty dyshohet se ai ka marrë xhiron ditore, një shumë prej rreth 500 mijë lekësh. Pas kërimit grabitësi u largua në drejtim të bllokut të pallateve pranë rrugës "Don Bosko", ku është ndeshur me një punonjës policie, të cilin i ka drejtuar pistoletën dhe i ka kërkuar të mos e ndjekë pasi përndryshe do ta qëllonte. Autori ka qenë i veshur me të zeza dhe



Autori i grabitjes

Raste të tjera grabitësh të shënuar nga autorë profesionistë kanë ndodhur edhe më herët në vendin tonë, një ndër to është grabitja në 30 qershor 2016 në aeroportin e Rinasit. Tre persona me armë e maska kaluan të gjitha sistemet e sigurisë së Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe hynë deri në pistën e avionëve. Pasi rrëmbyen disa thasë me para që do të transferoheshin jashtë me avionë, janë larguar sërish për të mos u kapur. Sipas policisë, grabitësit kanë qenë të paktën tre persona dhe kanë prerë menteshat në një nga portat e rrethimit të jashtëm të aeroportit. Pas grabitjes, autorët i priste në rrugë një automjet, me të cilin janë larguar drejt Fushë-Prezës. Policia nisi kërkimet nga ajri me helikopter dhe në një zonë të pyllëzuar gjeti një mjet tip "Benz" të djegur. Automjeti i përdorur për transportin e grabitësve rezultoi të jetë i vjedhur që në muajin mars në qytetin e Pogradecit. Për këtë rast u shpërndan në polici punonjësit e kompanisë private të sig-

mban në kokë një kapuç dhe një kapele me strehë. Policia ka shtrirë kërkimet

Grabitjet spektakolare në vend

Me armë në pistën e Rinasit, vjedhje në mes të ditës



Foto ilustruese

urisë që transportonte paratë dhe ata të caktuar për ruajtjen e portave të jashtme të aeroportit. Një rast tjetër i ndodhur më herët është grabitja spektakolare e një sasive prej 10 milionë lekësh të reja, 50 mijë euro dhe 30 mijë dollarë nga kasaforta e nëndheshme e filialit të Bankës Kombëtare Tregtare, që ndodhet në qendër të Tiranës, në zonën e ish-Bllokut. Në këtë grabitje autorët kanë shfrytë-


e saj në këtë zonë, ndërsa janë marrë edhe pamje të kamerave të sigurisë në disa

HETIMET

Policia ka shtrirë kërkimet e saj në zonën e 'Don Boskos', ndërsa janë marrë edhe pamje të kamerave të sigurisë në disa drejtime. Dyshohet se autori e kishte planifikuar gjithçka deri në detaj dhe ishte profesionist, pasi grabitjen e ka kryer për rreth një minutë. Blutë janë vendosur prej mesditës së hënë në kërkim të tij, por ende nuk është bërë i mundur arrestimi i të riut.

zuar edhe situatën e shiut të rrëmbyeshëm dhe zhurmën e bubullimave të rrufeve, prej të cilaverrugët ish-Bllokut kanë qenë të boshatisura gjatë gjithë natës. Për policinë dhe prokurorinë e Tiranës, dyshimet kryesorese mund të ketë gisht mbi këtë ngjarje kanë rënë mbi pronarin e lokalitit që ndodhej ngjitur me ambientet e bankës si dhe një dyshim tjetër është ngritur për administratorët e një parkingu privat, prej nga dyshohet të kenë hyrë autorët brenda në ambientet e lokalit dhe më pas në ambientet e bankës, nga ku kanë marrë sasinë e lekëve që përllogaritet diku tek 210 milionë lekë.

drejtime. Dyshohet se autori e kishte planifikuar gjithçka deri në detaj dhe ishte pro-



Vendi ku ndodhi grabitja

fesionist, pasi grabitjen e ka kryer për rreth një minutë. Gjithashtu, ka dyshime se grabitësi është ndihmuar edhe nga një tjetër person për t'u larguar me makinë. Autori mendohet se i ka dhënë çantën me para personit tjetër, ndërsa fshihet në një banesë në zonën e 'Don Boskos'. Sakaq bëhet me dije se forcat policore janë njoftuar nga alarmi i bankës sapo grabitësi është futur, por nuk mundën ta arrestojnë në flagrancë. Blutë janë vendosur prej mesditës së hënë në kërkim të tij, por ende nuk është bërë i mundur arrestimi i të riut.

PROVAT

Falë kamerave të sigurisë është bërë i mundur zbulimi i fytyrës së autorit të grabitjes së bankës. Mësohet se grabitësi ishte i veshur me të zeza dhe me një kapuç dhe kapele me strehë. Një provë që dyshohet se e ka tradhtuar grabitësin ka qenë çadra e harruar brenda ambienteve të Hipotekës. Ai është futur në Hipotekë me çadër në dorë dhe kur ka nxjerrë armën e ka hedhur atë. Por kur është larguar, ka harruar ta marrë me vete. Ndërsa nuk dihet ende nëse grabitësi ka përdorur doreza për të fshehur gjurmët. Ndërkohë ekspertë kriminalistë kryen veprime në vendngjarje për të bërë të mundur gjetje të gjurmëve që mund të çojnë në identifikimin e grabitësit. Sakaq policia e Tiranës vijon punën për identifikimin e autorit të kësaj ngjarje, i cili terrorizoi në mes të ditës Tiranën duke grabitur bankën në ambientet e një institucioni publik.

AUTORI

Një person i maskuar dhe nën kërcënimin e pistoletës grabiti ditën e hënë paratë e arkës në një bankë të nivelit të dytë brenda ambienteve të Hipotekës. Sipas burimeve, grabitësi ka pasur edhe një bashkëpunëtor, i cili po e priste jashtë godinës. Autori i ngjarjes, i cili dyshohet të jetë një i ri rreth moshës 25 vjeç, ka përdorur një kapuç dhe kapele me strehë për të fshehur identitetin.

GRABITJA

Mësohet se në brez autori ka pasur një armë zjarri tip pistoletë. Në momentin kur ka hyrë në ambientet e bankës, bëhet me dije se grabitësi nën kërcënimin e pistoletës, fillimisht kanosi policin privat, duke e mënjeluar tek muri dhe më pas u ka kërkuar punonjësve të bankës të mos lëvizin nga vendi. Më pas ai i është drejtuar sportelit të bankës private ku u ka drejtuar armën arkëtareve.



TIRANË - Vetëm një javë pas grabitjes së një argjendarie në Rrugën e Durrësit, policia e Tiranës ka arritur të zbardhë dhe dokumentojë ngjarjen. Specialistët për hetimin e krimit në Komisaratin e Policisë nr. 3 kanë identifikuar dhe arrestuar 23-vjeçarin Ardian Voca, banues në Kasallë Kamëz, Tiranë. Bëhet me dije se më 9 janar të këtij viti ai ka vjedhur me dhunë dyqanin në Rrugën e Durrësit, nën administrim të shtetases K.B., 19 vjeçe. Pas hetimeve njëjavore, blutë kanë rënë në gjurmët e autorit të krimit. Mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në godinën njëkatëshe, e cila ndodhet në fshatin Kasallë, nën administrim të shtetasit të lartpërmendur janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale sen-

23-vjeçarit i sekuestruohet malli i vjedhur

Grabitja e argjendarisë në Tiranë, policia zbardh ngjarjen, kapet pas 7 ditësh autori



Sendet e sekuestruara

det e vjedhura dhe konkretisht: 20 unaza, 15 varëse, 11 byzylykë, 4 ora dore, 3 mbajtëse unazash, 7 mbajtëse orësh si dhe një aparat celular. Materialet në ngarkim të Ardian Vocës iu

referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprimet të mëtejshme procedurale, për veprën penale "Vjedhja me dhunë". Pritet që Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës të vendosë

SEKUESTRIMI

Pas hetimeve njëjavore, blutë kanë rënë në gjurmët e autorit të krimit. Mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në godinën njëkatëshe janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale sendet e vjedhura.

masën e sigurisë ndaj tij. Gjatë ditëve të para të këtij viti, në Tiranë kanë ndodhur një sërë vjedhjesh. Nisur nga rastet e shënuara, blutë kanë marrë masa për parandalimin e ngjarjeve të tilla dhe rritjen e sigurisë në kryeqytet.

Ngjarja te Hipoteka, arrestohet polici privat e procedohet i lirë një tjetër

"Më jep lekët, ose të vras", dëshmitarët: Grabitësi i vuri arkëtares armën te koka

"Gjithçka ndodhi në 2 minuta. Të gjithë u terrorizua dhe nga frika u ulëm në tokë"

Ina Allkanjari

Një djalë i dobët, i gjatë dhe me kapele në kokë hyri i armatosur në ambientet e bankës dhe i vendosi armën në kokë sportelistes. Ai i tha me zë të vrazhdë: "Më jep shpejt paratë, ose do të të vras". Më pas agresori goditi me qytën e armës xhamin e bankës, i cili pësoi plasaritje dhe arkëtarja e tmerruar hapi kasafortën dhe i dha paratë. Gjithçka ndodhi në më pak se 2 minuta". Kështu kanë deklaruar gjatë marrjes në pyetje në polici, punonjësit e filialit të bankës së dytë, që ndodhet tek Hipoteka e Tiranës dhe që u grabit pas ditën e së hënës. Bazuar në të dhënat e dëshmitarëve okularë, policia e kryeqytetit e ka thauja se qartë pamjen e autorit të krimit, i cili dyshohet të jetë rreth 25 vjeç. Ndërkohë, mësohet se punonjësit e bankës që ishin në detyrë gjatë kohës kur ndodhi ngjarja kanë pohuar para oficerëve të policisë se grabitësi ishte me trup të dobët dhe rreth 170 cm i gjatë.

DËSHMITARËT

"Jemi tmerruar nga ajo që ndodhi. Menduam se grabitësi mund të na vriste, pasi ishte i armatosur", janë shprehur punonjësit e bankës. Ata kanë deklaruar se grabitësi ka qenë me një çadër në dorë, duke pritur jashtë ambienteve të Hipotekës dhe më pas e ka hedhur atë dhe është futur



Vendi ku ndodhi grabitja

me shpejtësi brenda. "Grabitësi ishte i dobët, rreth 170 cm i gjatë. Ai u fut, qëndroi tek dera e jashtme për pak çaste, mbuloi kokën me kapuç, hodhi çadrën dhe u fut në ambientet e brendshme të bankës ku kërcënoi me armë punonjësit, të cilët u ulën në tokë. Ndërsa arkëtares nëpërmjet xhamit i vuri pistoletën te

koka", kanë rrëfyer punonjësit në polici. Fillimisht qytetarët që ndodheshin në bankë nuk e kanë kuptuar çfarë po ndodhte, por pasi grabitësi ka ngritur zërin dhe ka urdhëruar sportelisten që t'i jepte paratë, disa prej tyre janë larguar menjëherë të frikësuar. Ndërkaj, mësohet se në momentin që agresori ka tentuar të dalë



jashtë, ai është përplasur me derën e xhamit, e cila është automatike dhe hapet me vështirësi. Dëshmitarët u shprehën se forcat policore kanë shkuar 5 minuta pas ngjarjes.

ARRESTIMI

Ndërkohë, në lidhje me këtë ngjarje dhe është vënë në pranga një punonjës i kompanisë private të sigurisë.

Bëhet fjalë për policin privat me inicialet F.F. Sipas burimeve policore, 48-vjeçari akuzohet për veprën penale "shpërdorim detyre". Kjo për faktin se ai nuk ka reaguuar në momentin e grabitjes ndaj personit që sulmoi zyrat e Agjencisë ADISA, pranë Hipotekës së Tiranës. Gjithashtu, është proceduar penalisht në gjendje të lirë nga

policia përgjegjësi i sigurisë së sallës operative të kompanisë private, 61-vjeçari me inicialet R.K.. Ata akuzohen për shpërdorim detyrës, pasi nuk kanë vepruar në momentin kur autori i armatosur hyri në ambientet e Hipotekës dhe nën kërcënimin e armëve grabiti rreth 500 mijë lekë të reja. Këto masa të policisë vijnë një ditë pas ngjarjes në rrugën "Panorama", ku rreth orës 14:00, brenda godinës së ZVRPP-së, një person me kapuç vodhi nën kërcënimin e armës një sasi lekësh në një bankë të nivelit të dytë, në sallën e shërbimit, e cila ishte në rruajtje të 48-vjeçarit F.F. Në lidhje me këtë ngjarje janë shoqëruar në polici rreth 30 persona, të cilët pasi janë pyetur, janë lënë të lirë. Ndërkohë, specialistët kundër krimeve kanë kryer veprimet e para hetimore dhe po punojnë intensivisht për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin dhe kapjen e autorëve. Në vendngjarje shkuan disa shërbime policore.

PROTESTA E 27 JANARIT OPOZITA

Kryetarja e LSI i kujton Ramës 21 janarin: Dhunën në protesta e solle ti

Protesta paqësore, Kryemadhi: Policia të mos provokojë qytetarët

"Shumë shpejt, përgjigjja për çadrën dhe çizmen"

Valentina Madani

Protesta e opozitës në 27 janar do të jetë paqësore, por kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi i bën thirrje policisë së shtetit që mos provokojë qytetarët. Në një bashkëbisedim me gazetarët, Kryemadhi ftoi dje të gjithë qytetarët në shesh, për t'i treguar kryeministrit Rama se ata janë kundër tij. "Protesta do të jetë paqësore ku të gjithë shqiptarët që ndihen të paspresë që kanë shumë pak mundësi punësimi që paguajnë më shumë, i ftojme që në 27 janar të protestojnë me prezencën tonë për t'i treguar Ramës që janë kundër tij", tha Kryemadhi. Para gazetarëve zj. Kryemadhi mohoi të ketë një skenar dhune nga opozita në 27 janar, por paralajmëron që të mos provokojë protestuesit. Në protestën e 18 dhjetorit, mbështetësi e PD dhe LSI tentuan të futen brenda në Kuvend, teksa mbahej seanca për zgjedhjen e kryeprokurores, Arta Marku. Në 27 janar, shprehet Kryemadhi, shqiptarët do t'i tregojnë Ramës se shumica e tyre janë kundër tij. Ajo akuzon Ramën se dhunën në protes-



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi

ta e solli ai, duke i kujtuar 21 janarin e 2011-ës. "Shqiptarët janë aq të lodhur dhe zhgënjyer, sa i përket situatës politike dhe në 27 janar do jetë paqësore ku të gjithë shqiptarët që janë të varfër që ndihen të paspresë, po duan të ikin nga sytë këmbët, i ftojme që në 27 janar të protestojmë që t'i tregojmë Ramës që shumica e qytetarëve janë kundër tij. Në imazhin e shqiptarëve është krijuar ideja e protestave të dhunshme, por dhunën e sol-

li zoti Rama në 21 janar, ishte shembulli më i keq i të bërit proteste. Ajo e 18 dhjetorit ishte shumë paqësore, nëse flakadanët quhen bomba molotovi..., policia dhunoi disa gra e vajza, dhuna s'është nga njëra anë, dhuna vjen kush e provokon dhe policia duhet të jetë kujdesshme që të mos provokojë", u shpreh Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së i është përgjigjur kryeministrit Rama në lidhje me firmën që ai e quan "ÇÇ" çizme dhe

REAGIMI

Policia e Shtetit i bëri thirrje PD-së të heqë dorë nga dhuna verbale, ndërkohë që si kundërpërgjigje z. Ristani tha: Të thuash të vërtetën nuk është dhunë verbale. Është verb, që qoftë edhe me ashpërsi apo forcë, kërkon të zgjidhet njerëzit e ndershëm të Policisë së Shtetit, ndjenjën e detyrës, respektimit të ligjit dhe dashurisë për këtë vend.

çadër: Gjatë bashkëbisedimit me gazetarët, Kryemadhi deklaroi se shumë shpejt Rama do të marrë përgjigje për këtë, pasi çizmes së krim-it shqiptarët do t'i përgjigjen me çizme. "ÇÇ-ja", ata e dinë shumë mirë se...do ta marrin përgjigjen shumë shpejt sa i përket edhe çadrës edhe çizmes. Çizmes së krim-it të organizuar me çizme do t'i përgjigjen shqiptarët. Kështu që zoti Rama e di më mirë nga të gjithë", theksoi zj. Kryemadhi.



Një nga protestat e opozitës

DREJTËSIA

Vasili: Qeveria "prostitucion" me Komisionin e Ligjeve

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili Kushtetutës. Vasili shprehet se qeveria tani po "prostitucion" me Komisionin e Ligjeve, ndërsa për reformën në drejtësi theksoi se ka vdekur. Ai e konsideron Komisionin e Ligjeve si komision antiligjor: Reagimi i Vasili vjen ndërkohë që Komisioni i Ligjeve rrezoji propozimet e opozitës për ndryshimet e Kushtetutës për mënyrën e zgjedhjes së kryeprokurorit të përkohshëm. "Kushtetutën e shqetë kryeministri në 18 dhjetor kur zgjodhi prokuroren me 69 vota të rillindjes. Tani po prostitutojmë me këtë Komisionin e (anti)Ligjeve që t'i venë flakën përfundimisht. Vetëm me vota të rillindjes dhe me asgjësimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit nga kryeministri reforma në drejtësi ka vdekur", shprehet z. Vasili.



Policia: PD të heqë dorë nga dhuna verbale

Vetingu, Ristani: Rrokadë, trafikantë në vend të policëve

PD-ja e konsideron një propagandë të qeverisë vetingun e nisur në polici nga ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Sekretari i përgjithshëm i PD, Arben Ristani tha dje se publikimi në disa media i lidhjeve të ish-ministrit të Brendshëm, Tahiri dhe disa zyrtarëve të lartë të Policisë së Shtetit me trafikun e drogës, janë fakte të reja që provojnë se në polici nuk po ndodh veting, por zëvendësimi i një kupole mafioze me një tjetër. "Sipas raportit zyrtar të shërbimit sekret, 128 oficerë policie, përfshirë edhe drejtues të lartë të saj, kanë marrë pjesë



dhe kanë përfutuar nga trafiku i kanabisit. Deri tani nuk është bërë publike asnjë masë e marrë ndaj tyre, ndërsa tre drejtues të policisë në qarqe, të akuzuar për lidhje me Habilajt dhe Tahirin, janë në arrati. Urdhri i Ministrit të Brendshëm Xhafaj, për pezullimin e oficerit të përfshirë

në trafikun e kokainës është veç një nga masat propagandistike, sepse media raporton se Julian Balliu është arratisur, njësoj si tre drejtuesit e tjerë të lartë të policisë. Pezullimi nga Xhafaj është propagandë, njësoj si vetingu që thotë se do të bëjë në polici vëllai i Agron Xhafes, që është dënuar për trafik ndërkombëtar kokaine", deklaroi z. Ristani. Sipas tij pa largimin e Fatmir Xhafes dhe Edi Ramës, si koka që mbrojnë krimin e organizuar në Shqipëri, nuk do të ketë veting të vërtetë në polici dhe as rend dhe siguri për shqiptarët.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit 'Autoclear' të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,500,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraqitsh pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas datave të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit 'Autoclear' të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 20 Shkurt 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



MESAZHI

"John Lennon, me këngën e tij të famshme 'War is over, if you want it', 'Lufta mbaron po të duash ti'. Edi Rama mbaron, po të duash ti. Ky është mesazhi që do t'i japim çdo shqiptari. Po të duash ti, po të duam ne, Edi Rama mbaron. Ky është mesazhi i protestës. Po të ngrihet populli, po të bashkohen qytetarët, Edi Rama mbaron", - tha Basha.



Astrit Patozi

Protesta, Patozi-Bashës: "I vonuar", po shkon në luftë me këngë paqeje

Një nga kritikët e tij më të ashpër, i cili u la jashtë listës së kandidatëve për zgjedhjet e 25 qershorit, Astrit Patozi, ironizoi dje sërisht kreun e opozitës, Lulzim Basha. Ai shkruan në një postim në rrjetin social "Facebook" se u ka rënë kot në qafë disa personave kur publikisht patën thënë se Lulzim Basha është "i vonuar". "U paskam rënë kot me qafë disa të mërziturve publikë me Lulzim Bashën. Sepse deri më sot mendoja se termi 'i vonuar', që ata përdornin për të, ishte pak i rëndë dhe i ekzagjeruar. Por tani po shoh sloganin e protestës së 27 janarit, i cili qenka frymëzuar nga një këngë e hershme e John Lennon. Atë e paska shpallur Lulzim Basha si një gjetje të veçantë të vendit apo të ndonjë këshilltari jodjazstër, pak rëndësi ka. Kënga i përket vitit 1971, por nuk është moshë e saj që e bën të duket kaq të vonuar Lulin. As fakti që ajo është një lloj himni Krishtlindjesh dhe u bë një copë kohë që e kemi lënë pas atë festë. Ne këtu ishim gjithësi, edhe populli i mërzitur nga qeveria, edhe viktimat e narkoshtetit, edhe ata që duan të ikin nga Shqipëria, por nuk kanë mundësi, ndërsa Luli vetë ishte në Holandë. Jo vetëm për Krishtlindje, por edhe për Vitin e Ri. Tamam si në tekstin e këngës së John Lennon, që u drejtohet të dyja festive", tha Patozi. Por sipas tij, "një Zot e di se pse i ka ngelur mendja tek ajo këngë e vjetër, që i kushtohet paqes, në kohën që po përgatitet të shkojë në luftë? Sepse nuk besoj që Basha ka ndërmend të rrezojë qeverinë e drogës, duke mbajtur në dur degën e ullirit. Të jetë bërë Gandhi-st vallë Lulzim Basha, apo është thjesht 'i vonuar', siç thonë prej kohësh disa figura publike?", u shpreh z.Patozi.

Mesazhi i kreut të PD: Po të ngrihet populli, po të bashkohen qytetarët, Rama mbaron

Basha citon John Lennon: Lufta mbaron po të duash ti

"Tahiri përfiton 5 mln euro në muaj nga trafikantët"

Valentina Madani

Kreui i opozitës, Lulzim Basha përmes këngës së famshme "War is over, if you want it", "Lufta mbaron po të duash ti", përcolli dje mesazhin e protestës së Edi Rama mbaron politikisht kur të duan shqiptarët. Sipas Bashës, po të ngrihet populli, po të bashkohen qytetarët, Edi Rama mbaron. Kreui i PD-së bëri të ditur se nisja e opozitës për zgjedhjen e një Prokurorit të Përgjithshëm sipas Kushtetutës dhe me veting është treguesi më i qartë i vullnetit të opozitës për zbatimin e reformës në drejtësi, të pakapur nga krimi. "E pra, ky është një akt i përgjegjshëm politik, i cili bëhet për t'ia davaritur çdokujt dyshimin se Partia Demokratike ka ndonjë axhendë tjetër, përveçse përshpejtimin të reformës në drejtësi. Se afërmenësh, opozita nuk ka dhe nuk mund të ketë aleatë më të mirë në luftën kundër krimi dhe kriminelëve dhe të korruptuarve, se sa një drejtësi që funksionon", - u shpreh Basha. Në aktivin me disa degë të Tiranës, kreui i opozitës tha se, nëpërmjet kryeprokurorit antikushetues, Rama synon të blloktoj heqjen e Saimir Tahirit dhe të diktoj zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për të kontrolluar më pas edhe Prokurorinë e Posaçme për luftën kundër krimi dhe korupsionit, duke shkatërruar themelet e reformës në drejtësi. "Saimir Tahiri kapet nga antimafia duke përfutur ar dhjetëra, mijëra euro varësë e byzylykë floriri. 5 milionë euro në muaj nga trafikantët e drogës dhe Edi Rama ndalon arrestimin e tij. Përse? Fare e thjeshtë, sepse arrestimi i Saimir Tahirit është hapi i parë drejt arrestimit dhe vënien para drejtësisë të Edi Ramës, si koka dhe arkitekti i kanabizimit dhe kriminalizimit të Shqipërisë. Po mbron veten e tij. Kaq e thjeshtë është!", - theksoi kreui i PD-së. Sipas tij, protesta e 27 janarit nuk është një manifestim për interesin e një force politike, por për t'i dhënë zë shumicës së shqiptarëve. "Ne jemi njëriëz-it që kemi ditur të sakrifikojmë edhe interesat tona




Kreui i opozitës, Lulzim Basha

"Rama-Basha qeverisin sipas paktit të 18 majit"

Topalli: Basha është bërë bedel i qeverisë dhe ortak i oligarkëve

Ish-kryetarja e parlamentit, Jozefina Topalli deklaroi dje se vendi është pa qeveri dhe opozitë, ndërsa sipas saj, Basha dhe Rama vijojnë bashkëpunimin mes tyre në bazë të marrëveshjes së 18 majit. "Gjatë kësaj periudhe kemi parë të gjithë që Basha është bërë bedel i qeverisë dhe ortak i oligarkëve. Mjafton të kujtojmë pjesë nga seancat parlamentare të muajve të kaluar, kur kryeministri i kërkon Bashës të flasë për emrat e oligarkëve dhe i përmend me emër dhe ky ul kokën dhe nuk guxon të thotë një fjalë. Në këto kushte kur opozita kontrollohet nga qeveria për shkak të korruptimit dhe arsyeve të tjera të lidershit të saj, i bie që vendi ynë është në buzë të greminës se kështu bie demokracia dhe nuk ekziston më asnjë garanci për mbrojtje



THIRRJA

"Nëse qytetarët nuk ngrihen në protestë për të rrezuar edhe Edin, edhe Lulin, edhe Monën, edhe ata që kanë pushtetin, ky vend do udhëhiqet edhe për 20 vjet të tjera nga Luli, Lali Eri, Mona dhe Edvini", tha Topalli.

tjen e drejtave të njeriut", tha Topalli për "Report TV". Sipas saj, protesta e ardhshme është thirrur si presion për të rinegociuar 18 majin. "Çfarë pritsshmërie mund të ketë nga një protestë që kërkon të rinegociojë 18 majin, që sipas medias ishte për dhjetëra miliona euro të palatit në 'Ujin e Ptohtë', ndaj thashë që vendi është në buzë të greminës. Përgjigjes për pritshmërinë i është përgjig-

jur vetë Basha dje në një televizion, ku thoshte që 'nëse nuk doni të paguani taksen e Lulit, vjehrrit dhe kunatit, duhet të rrezoni Edi Ramën. I bie që nuk ia kërkonë paratë Ramës, por u thoshte qytetarëve 'o më paguani parat, o më jepni pushtetin se alternativë tjetër nuk ka'. Pra, vendi është pa opozitë dhe ata janë bashkë", tha Topalli.

politike dhe partiake, siç ishte marrëveshja e 18 majit, për interes të Shqipërisë, ndaj nuk shkojmë për karrierën tonë. Nuk shkojmë për të bërë Lulzim Bashën kryeministër. Shkojmë për të çliruar Shqipërinë nga krimi. Për të çliruar drejtësinë nga krimi. Për të çliruar qeverinë dhe ekonominë nga krimi. Vetë protesta do të jetë numerikisht shumë e shumë herë

më e madhe se bashkimi i kopukëve dhe horrave e kriminelëve të Edi Ramës, ndërsa zëri i protestës do të jetë zëri i shumicës absolute të shqiptarëve", theksoi z.Basha. Kreui i opozitës shprehu bindjen se në protestë shumica e shqiptarëve do të tregojnë se nuk pajtohen me aleancën e krimi të ndërtuar nga Edi Rama, që po i varfëron çdo ditë dhe po e bën jetën e familjeve sh-

REFORMA NE DREJTESI NDRYSHIMET

Ndryshimet kushtetuese, kreu i Komisionit të Ligjeve i përgjigjet PD-LSI

Manja: Nuk ka asnjë lloj kompromisi në kurriz të Kushtetutës së vendit

Hapen sot procedurat për KLGJ e KLP

Darina Tanushi

Kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, Ulsi Manja i bëri të qartë dje opozitës se nuk do të ketë kompromis për paketën e ndryshimeve kushtetuese që ajo ka propozuar. Në një bashkëbisedim me gazetarët, Manja sqaroi se Kuvendi dhe institucionet janë në fazën e zbatimit të reformës në drejtësi. "Palët politike e kanë shprehur vullnetin politik me ndryshimet kushtetuese dhe me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi, që tashmë janë në fuqi. Kështu që jemi në një fazë teknike të zbatimit të reformës. Kështu që do të vazhdojmë të ecim përpara sepse dakordësimi dhe vullnetin politik palët e kanë shprehur me ndryshimet kushtetuese të mesnatës së 21 dhe 22 korrikut", deklaroi Manja. "Nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë lloj kompromisi në kurriz të Kushtetutës së vendit, që e kemi miratuar bashkërisht dhe me vullnet të plotë me 140 vota, aq më tepër kur në këtë proces të reformës në sistemin e drejtësisë, duke filluar që me ndryshimet kushtetuese dhe deri sot, kryetari i mazhorancës e ka bërë të qartë se nuk jemi vetëm", u shpreh më tej Manja. Sipas tij, "vijërojtësit e kësaj reforme janë partnerët tanë, SHBA-të dhe BE-ja, nëpërmjet dy misioneve që asistojnë drejtësinë, EURALIUS-it dhe OPDAT-it". Kështu që unë nuk kam përgjigje tjetër, përveç kësaj që sapo ju thashë. Manja njoftoi se sot, Komisioni i Ligjeve hap procedurat për ngritjen e KLP

dhe KLGJ. "Sipas Kushtetutës dhe ligjit, vendimmarrja i takon nënkomisionit ad hoc, që do të ngrihet sot - tha Manja - duke sqaruar hapat për ngritjen e këtyre institucioneve të reja". "Cilado të ketë qenë vendimmarrja e institucioneve të përfshira në procesin e filtrimit të kandidatëve, qoftë Avokati i Popullit, qoftë

trupa e pedagogëve, qoftë trupa e avokatëve, qoftë ONM-ja, qoftë sekretari i përgjithshëm, që ka një rol në këtë proces, në finale vendimmarrja i takon nënkomisionit ad hoc që do të ngrihet nesër; (sot) me përbërjen që e kanë caktuar Kushtetuta dhe ligji, 5 anëtarë, 3 shumica, 2 pakica dhe ky komision do të ketë mbi

tryezën e punës të gjithë dokumentacionin e të gjithë kandidatëve, si të atyre që i plotësojnë kriteret formale, por edhe të atyre që nuk i plotësojnë kriteret formale", shpjegoi Manja. I pyetur nëse mazhoranca do të tentojë të marrë një dakordësi nga opozita, Manja tha: "Unë e ftoj opozitën, në vazhdim e të gjitha ftesave që kanë bërë përfaqësuesit e mazhorancës, të ulen në këtë komision shumë të rëndësishëm, sepse faza e zbatimit të reformës në drejtësi është shumë e rëndësishme dhe jemi në një fazë kritike. Nëse i gjithë shqetësimi ka qenë ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, më në fund nesër do të kemi hapjen e procedurave".



Lista me emrat që do të rivlerësohen nga KPK

Hidhet shorti, 36 gjyqtarë e prokurorë në sitën e vetingut

36 gjyqtarë e prokurorë, mes të cilëve edhe drejtues gjykatash e prokurorish, do t'i nënshtrohen procesit të vetingut pas shortit të hedhur së fundmi në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Në njoftimin për shtyp të KPK theksohet se, "në zbatim të ligjit nr. 84/2016 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të pikës 11 të nenit 3 dhe të pikës 4 të nen-



it 6 të Rregullores për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit", më datë 15.01.2018 janë shortuar dhe kanë filluar procedurat e rivlerësimit për subjektet e riv-

lerësimit". Në listën e gjyqtarëve dhe prokurorëve vihet re se bëjnë pjesë edhe dy prej kandidatëve që konkurruan për postin e prokurorit të përkohshëm të përgjithshëm, Arqilea Koça nga Prokuroria e Përgjithshme, si edhe Ferdinand Elezi, drejtues, Prokuroria e Apelit Durrës. 10 prokurorë i përkasin pikërisht Prokurorisë së Edhë kandidatë për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

LISTA E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE QË DO T'I NËNSHTROHEN VETINGUT:

- Enton Dhimitri - Gjykata e Apelit, Gjirokastrë, kandidat për KED.
- Fatos Qato - Gjykata e Apelit, Tiranë, kandidat për KED.
- Ahmet Jangulli - Gjykata Administrative, Shkodër, kandidat për KED.
- Sotiraj Lubonja - Gjykata e Apelit, Korçë, kandidat për KED.
- Adnan Xholl - Prokuroria e Përgjithshme
- Adnan Kosova - Prokuroria e Përgjithshme.
- Alfred Progonati - Prokuroria e Përgjithshme.
- Alma Muça - Prokuroria e Përgjithshme.
- Arben Kraja - Prokuroria e Përgjithshme.
- Arqilea Koça - Prokuroria e Përgjithshme.
- Artur Selmani - Prokuroria e Përgjithshme.
- Petrit Fusha - Prokuroria e Përgjithshme.
- Sokol Stojani - Prokuroria e Përgjithshme.
- Thoma Jano - Prokuroria e Përgjithshme.
- Alma Liçaj - Kryetare e Gjykatës së Apelit Civil, Vlorë.
- Dritan Banushi - Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil Gjirokastrë
- Entela Prifti - Kryetare e Gjykatës së Apelit Civil, Korçë.
- Fuat Vjerdha - Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil, Shkodër.
- Hysni Demiraj - Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil, Tiranë.
- Petrit Çeno - Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil, Durrës.
- Fehmi Petku - Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.
- Dritan Peka - Drejtues, Prokuroria e Apelit Tiranë.
- Altin Binaj - Drejtues, Prokuroria e Apelit Vlorë.
- Elvin Gokaj - Drejtues, Prokuroria e Apelit Shkodër.
- Irma Balli - Drejtues, Prokuroria e Apelit Korçë
- Alfred Agolli - Drejtues, Prokuroria e Apelit Gjirokastrë.
- Ferdinand Elezi - Drejtues, Prokuroria e Apelit Durrës.
- Artan Bajrami - Drejtues, Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda.
- Bujar Sheshi - Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda.
- Admir Belishta - Kryetar i Gjykatës së Rrethit Korçë.
- Agron Vavla - Kryetar i Gjykatës së Rrethit Berat.
- Albina Lako (Spahaj) - Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë.
- Alfred Gjoni - Kryetar i Gjykatës së Rrethit Kurbin.
- Alltun Çela - Kryetar i Gjykatës së Rrethit Sarandë.
- Alma Hoxha (Kolgjoka) - Kryetare e Gjykatës së Rrethit Krujë.
- Arben Zefi - Kryetar i Gjykatës së Rrethit Shkodër.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbasues gjyqësor privat Artan Sima, në datë 8/02/2018, ditën e Hënë, ora 16.00, përfundon ankandin e ri (të dytë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "trualet" me sipërfaqe 300 m², nga e cila ndërtesë me sipërfaqe 94 m², e ndodhur në Trevllazër, rrethi Vlorë në vlerën 280.000 lekë. Pasuria është lenë garanci bankare nga debitorët z.Fatmir e Fatmiretë Ismajaj banues në lagjen "24-Maj" tek Pishat Vlorë për detyrimin ndaj kreditorit Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit (FAF) Sh.a, me seli në Tiranë, Dega Rajonale Vlorë. Ankandi zhvillohet pranë zyrës së përmbasuesit me seli lagjen nr.3. Rruga "Avni Rustemi", nr.31 .k.1. Korçë. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria përmbasimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme **Apartment**, me sipërfaqe **98.39 m²** (nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nëntë metra katrorë), e regjistruar në Zonën Kadastrale Nr. 8603, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 322, datë 19.11.2004, Numri i Pasurisë 26/121-2-7, Vol. 17, Faqe. 243, me adresë: **Laçja "28 Nëntori", Vlorë**, në pronësi të **Edlira Aibaj**, për kreditin e marrë pranë Bankës NBG Albania Sh.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i dytë është **25,600.00 (njzet e pesë mijë e gjashtëqind) Euro**. Ankandi do të zhvillohet datë **14.02.2018**, ora **16:00**, në adresën: **Qendra e Zhvillimit të Ankandëve Publike Përmbasimore ("QZHAPP")**, me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbasuesve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofertues duhet të deponojë si garanci në illogarinë e **ARB** me **IBAN AL21901110510027173510016018** në **EURO** pranë Bankës **NBG Albania** shumën prej **10 %** (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përmbasimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall.: 21, Shk.: 3, Ap.: 3, Tiranë; tel: 042 252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria përmbasimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme **Apartment**, me sipërfaqe **59.5 m²** (pesëdhjetë e nëntë pikë pesë metra katrorë) e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr 2291, Pasuria me Nr. **306/68-1-18**, vol. 21, Fq. 245, me adresë në: Kryemadhej, Kavajë, në pronësi të **Edmond Zyberi**, për kreditin e marrë pranë Bankës NBG Albania Sh.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i dytë është **15,360.00 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Euro**. Ankandi do të zhvillohet datë **14.02.2018**, ora **17:00**, në adresën: **Qendra e Zhvillimit të Ankandëve Publike Përmbasimore ("QZHAPP")**, me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbasuesve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofertues duhet të deponojë si garanci në illogarinë e **ARB** me **IBAN AL21901110510027173510016018** në **EURO** pranë Bankës **NBG Albania** shumën prej **10 %** (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përmbasimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pall.: 21, Shk.: 3, Ap.: 3, Tiranë; tel: 042 252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al



Presidenti flet për raportin me Ramën e Ruçin: Secili të bëjë detyrën

Ilir Meta: Koha për një dialog strukturor mbi reformat kyçe

"Nuk e kemi luksin që ta humbasim këtë mundësi në muajin maj"

Genç Milloja

Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje se është koha për dialog të mirëstrukturuar, në mënyrë që vendi të humbasë momentin për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në një intervistë dhënë gazetës "Albanian Daily News", Meta tha: "Është tamam koha për një dialog strukturor mbi reformat kyçe, që kanë nevojë për zbatim të shpejtë".

Cilat janë pritshmëritë tuaja për zhvillimet politike në vitin 2018, ndërsa disa vendime të njëanshme të kësaj mazhorance, duke përfshirë ato në drejtësi, kanë ndeshur në shumë raste kundërshkrimin e opozitës, e cila nga ana e saj ka njoftuar për një përkallëzim të luftës politike, përfshi edhe protesta masive, duke filluar nga muaji janar?

Interesi më i lartë dhe i mirë i vendit janë stabiliteti, forcimi i sigurisë kombëtare dhe pavarësia e institucioneve. Kjo është gjithashtu, pritimëria ime si president dhe thirrja ime e fortë për të përbushur këto interese nëpërmjet dialogut dhe bashkëpunimit të vërtetë. Ndërsa, reforma në drejtësi është në një fazë shumë të rëndësishme, ajo duket e pozicionuar në një udhëkryq, e cila mund t'i japë një kuptim dhe besim të ri drejtësisë në Shqipëri, ose të keqperdorret për të përkallëzuar konfliktin politik. Si President i Republikës,



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

unë mund të përsëris me forcë rëndësinë e zbatimit të reformës në përphtje me Kushtetutën dhe rekomandimet e Komisionit të Venedicimit, si garantuesi i vetëm i ndërtimit të institucioneve të pavarura të drejtësisë që të jenë funksionale, të qëndrueshme dhe të pavarura. Po kështu, një luftë e menjëhershme, e fortë dhe efiçase kundër krimit të organizuar dhe lidhjeve të tij me qeverisjen publike është një përparësi kyçe e lidhur jo vetëm me perspektivën evropiane, por çka është më e rëndësishmja, me të gjithë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Nëse përmbledhen disa nga konstatimet tuaja, duket se ato janë pjesë e "detyrës së shtëpisë" të vënë nga Bashkimi Evropian për të ndërmarrë hapin e mëtejshëm për të filluar bisedimet e anëtarësimit me këtë bllok. Cila është kështu kjo që të bëhet realitet kjo ëndërr e shqiptarëve?

Bashkimi Evropian ka parashtruar 5 përparësi të garta si parakusht për të hapur bisedimet e anëtarësimit me Shqipërinë. Përparimi i arritur për zbatimin e shpejtë dhe të gartë të reformës në drejtësi, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, veçanërisht tregunë kultivimit dhe trafikimit të marijuanës, të drejtat e pronës, reforma në administratën publike dhe respektimi e mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe të shqyrtohen në muajin prill nga Komisioni Evropian para një vendimi përfundimtar të Këshillit të Evropës këtë qershor. Sikurse ka vënë në dukje me dashamirësi Presidenti Tusk, Shqipëria ka shumë më të mirë dhe të zellshëm ndërmjet anëtarëve të Bashkimit Evropian, të cilët vazhdojnë të na mbështesin për procesin tonë të anëtarësimit. Megjithatë, entuziazmi i tyre nuk është i mjaftueshëm që t'i caktohet një

datë vendit tonë për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit. Ne duhet të prodhojmë një bilanc bindës faktesh dhe rezultatesh, që të provojmë përparimin e vërtetë të vendit. Dua të theksoj rëndësinë që vetë Bashkimi Evropian po i jep Ballkanit Perëndimor nëpërmjet presidencës bullgare, e cila ka përcaktuar perspektivën evropiane të rajonit si një ndër katër përparësi kyçe të presidencës së saj.

Megjithatë, ata kanë vënë në dukje se këto pritshmëri duhet të jenë realiste dhe brenda kuadrit të përparimit të mbështetur mbi meritën, që nënkupton në shumë punë dhe përgjegjësi nga ana e jonë. Unë shpresoj se ky mesazh është perceptuar dhe kuptuar saktë nga të gjitha nivelet ligjberëse në vend. Ne nuk e kemi luksin që ta humbasim këtë mundësi të re gjatë Takimit të Nivelit të Lartë të Sofjes në muajin maj.

Tashmë është bërë pothuajse si një "legjendë" letra që i keni shkruar Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump. Zoti President, a mund të na tregoni motivet që ju shtynë të ndërmerri një hap të tillë historik, duke mos mbështetur vendimin e qeverisë kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Izraelit?

Shqipëria është një vend modest në shkallë botërore. Ne duhet të balancojmë mirë peshën tonë specifike në raport me partnerët dhe aleatët tanë dhe aq më tepër kur është fjala për partnerë strategjikë. Dy asetatona më të mëdha në marrëdhëniet e jashtme janë modestia dhe besueshmëria. Askush nuk duhet ta komprometojë këtë. Besoj fort se ne të gjithë duhet të ruajmë me maturi dhe zgjuarsi besueshmërinë tonë ndaj aleatëve tanë strategjikë në mënyrë të mirë dhe interesave të shtetit dhe interesave tona kombëtare. Si President i Republikës, unë duhet dhe

do të jem transparent ndaj partnerëve tanë dhe opinionit publik mbi çdo vendim të rëndësishëm diplomatik, veçanërisht mbi çështje që lidhen me sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kuptim, është detyra dhe përgjegjësia ime të siguroj se nuk ka asnjë hije në marrëdhëniet tona me partnerin tonë më të rëndësishëm strategjik, Shtetet e Bashkuara, me të cilin jemi gjithashtu të lidhur me një marrëveshje të partneritetit strategjik për çështje të sigurisë. Për hir të këtyre marrëdhënieve të interesit jetik për Shqipërinë dhe të gjithë shqiptarët në rajon, mua më duhet të isha transparent në mesazhin tim të përgjigjes drejtuar Presidentit Trump, duke e siguruar atë për bashkëpunimin e palëkundshëm. Për më tepër, kjo ishte një votë e lidhur me një vendim sovran të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i cili nuk ishte ligjorisht detyrues për të gjithë vendet e tjera.

Në vijim të pyetjes së mësipërme, si e shikoni të ardhmen e raportit Presidencë-Kryeministri-Kuvend në vitin 2018, meqenëse legjislativi është i dominuar nga mazhoranca?

Është e domosdoshme që çdo institucion të kryejë detyrat e funksionet e tij përkatëse, duke u mbështetur mbi Kushtetutën dhe kuadrin ligjor në fuqi. Shqipëria po hyn në një fazë të rëndësishme të integritimit evropian dhe të gjitha përpjekjet duhen përqendruar për të kapur këtë mundësi më mirë herët sesa vonë. Është tamam koha për një dialog strukturor mbi reformat kyçe, që kanë nevojë për zbatim të shpejtë.

Shumë është folur për një kod etike në jetën parlamentare, politike dhe shoqërore në Shqipëri. Meqenëse ju qëndroni mbi partitë, a mendoni se Shqipëria është e përgatitur të vendosë disa standarde në Kuvend, por edhe jashtë tij, pasi politikanë të lartë të rangjeve më të larta janë ndër ofenduesit kryesorë të kulture dhe vlerave gazetare dhe qytetarëve të thjeshtë, por çka është më e turpshme, janë ofendimet publike kundër grave të përfshira në politikë?

Kultura e komunikimit publik në Shqipëri ka nevojë për një rimësim serioz. Ajo ka një efekt të drejtpërdrejtë mbi shoqërinë, madje edhe në komunikimin e përditshëm të njerëzve. Një kod etike në Kuvend dhe në vende të tjera pune vendos një standard të mirë dhe ndihmon, nëse nuk shman, për minimizimin e gjuhës ofenduese dhe diskriminuese kundër të tjerëve.

Aktiviteti për Vitin e Skënderbeut

Rama: Po mundohemi të ngjسیم copëzat e pasqyrës së thyer të Skënderbeut

Kryeministri Edi Rama lajmëroi se në nëntor, Samiti Diasporës do të sjellë në Tiranë të gjithë shqiptarët, nga ku ata kanë emigruar, me rastin e Vitit të Skënderbeut. Në një aktivitet të titulluar "Tri ditët e Yllit të Mëngjesit" u cel dje sipari i "Vitet të Skënderbeut" në nder të 550-vjetorit të heroit kombëtar, Rama tha: "Viti i Skënderbeut, jubilar për të gjithë shqiptarët. Skënderbeu është një histori suksesi. Për vetë heroin tonë ka një dashuri të madhe kudo në botë. Ai është një figurë themelore për të gjithë shqiptarët. Në këtë hapësirë, në këto ditë ndoshta nuk mund të ekspozohet gjithçka, unë them një shprehje latine 'venite e vedrete' (ejani dhe shihni). Nuk mund të lë pa përmendur që sot 150 arbëreshë kanë ardhur në tokën më të për të kujtuar figurën më të lartë të historisë. Shumë prej tyre vijnë për herë të parë në Shqipëri, pasi po mundohemi që të ngjسیم copëzat e pasqyrës së thyer të Skënderbeut. Të gjithë së bashku ne do i presim të gjithë arbëreshët, që sjellin këtu komunitetin e tyre. Në samitin e diasporës, në nëntor do të sjellë të gjithë bijat dhe bijtë të Skënderbeut kudo që janë", u shpreh ai.

NJOFTIM ANKANDI

Përmbaues gjyqësor privat Artan Sima zhvillon ankandet sipas datave të mëposhtme:
 1)Datë 25/01/2018, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i parë), për shiljen e pasurive të paluajtshme të llojit: -"Are" me sip. 2506 m², e ndodhur në fshatin Vashtri Korçë, në vlerën 300,720 leke. -"Are" me sip. 1216 m², e ndodhur në fshatin Vashtri Korçë, në vlerën 145,920 leke. -"Are" me sip. 1080 m², e ndodhur në fshatin Vashtri Korçë, në vlerën 173,520 leke. -"Truall+are" me sip. 352 m², nga kjo truall 200 m², si dhe ndërtesa prej 80 m², e ndodhur në fshatin Vashtri Korçë, në vlerën 2,080,720 leke.
 Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor z. Algent Minir Panajoli, znj. Manjola Rexhep Panajoli, znj. Sara Algent Panajoli, z. Glediol Algent Panajoli banues në fshatin Vashtri Korçë, bashkia Maliq, rrethi Korçë, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a. me seli në ish Blloku Tiranë.
 2) Datë 25/01/2018, ditën e Enjte, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i parë), për shiljen e pasurive të paluajtshme të llojit: -"Are" me sip. 1489 m², e ndodhur në fshatin Zagradec Devoll, në vlerën 124,900 leke. -"Are" me sip.1489 m², e ndodhur në fshatin Zagradec Devoll, në vlerën 153,600 leke. Pasuritë janë lene garanci bankare nga debitori Trashëgimtarëve të të ndjerit/Debitor z. Xhevar Zama dhe Nexhmije Zama, z. Aurel Zama, z. Sokol Zama, z. Melis Zama, banues në fshatin Zagradec, bashkia Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a. me seli në ish Blloku Tiranë.
 3)Datë 8/02/2018, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i dytë), për shiljen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Are" me sip. 4,312 m², e ndodhur në Lasaj, Dibër, në vlerën 434,649 leke. Pasuria është lene garanci bankare nga debitorët trashëgimtare znj. Nafie Bitri, z. Elda Shquti (Bitri), z. Shkelqim Bitri, znj. Merita Toci (Bitri), znj. Fitore Lala (Bitri), znj. Vjollca Vashlef (Bitri), znj. Elvira Bitri banuese në fshatin Fushe-Cidhen, Rrethi Dibër.
 4)Datë 8/02/2018, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i tretë), për shiljen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall" me sip. 190 m², nga kjo ndërtesë 81 m², e ndodhur në fshatin Koshnice-Devoll në vlerën 252,000 leke. Pasuria është lene garanci bankare nga (debitorët/hipotekues) z. Ylli Islam Palla dhe znj. Lule Osman Palla, banues në fshatin Koshnice, Devoll, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a. me seli në ish Blloku Tiranë.
 5)Datë 8/02/2018, ditën e Hënë, ora 16:00, përfundon ankandi i ri (i dytë), për shiljen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Are" me sip. 1,000 m², truall 190 m², nga kjo ndërtesë 81 m² e ndodhur në fshatin Zdojan, Dibër, në vlerën 112,000 leke. Pasuria është lene garanci bankare nga (debitorët/hipotekues) z. Bedri Allaman Tuka, banues në fshatin Zdojan-Brezhan, bashkia Dibër, rrethi Dibër, për detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli në ish Blloku Tiranë.
 Ankandet zhvillohet pranë zyrës së përmbauesit me seli lagjen nr. 3, Rruga «Avni Rustemi», nr.31, k.1, Korçë. Kontakti Cel.0674044666, e-mail: simartan@yahoo.com

Ministri, 13 dokumentet që mund të merren pa shkuar në zyra

Ahmetaj, letër biznesit: Taksat dhe tatimet që mund të paguani 'online'

Pagesa e sigurimeve dhe marrja e vërtetimit, pa shkuar në ISSH

Ornela Manjani

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj u kërkon bizneseve që të dërgojnë propozimet e tyre për reformën e derregullimit deri në datën 15 shkurt. Në letrën drejtuar bizneseve, Ahmetaj shkruan se propozimet mund të dërgohen në adresën zyrtare të internetit të ministrit. "Propozimet tuaja për procedurat që mund të preken në funksion të thjeshtimit, eliminimit apo ofrimit online si dhe për lejët, licencat dhe autorizimet që konsideroni se përbëjnë mbirregullim të tregut janë mëse të mirëpritura për t'u kthyer në një platformë të re dialogu dhe konsultimi mes nesh shumë shpejt në një tryezë të përbashkët", shkruhet në letër ku evidentohej se nga janari do të ketë thjeshtime të tjera procedurash. Më tej, ministri evidenton se duke nisur nga 1 tetori i vitit të kaluar, janë 13 dokumente që nuk kërkojnë më nga qytetarët dhe sipërmarrja për shërbimet që ofrohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. "Vetëm përmes heqjes së detyrimit për dorëzimin e këtyre dokumenteve nga qytetarët dhe sipërmarrja u kemi kursyer atyre rreth 595 mijë dokumente dhe 56 vite kohë pritje në radhë e



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

sportele vetëm në një vit" shkruhet në letër. Qeveria shqiptare ka prezantuar prej muajsh një nga reformat kryesore të mandatit të dytë, me në fokus përmirë-

simin e shërbimeve publike për biznesin dhe qytetarin, uljen e peshës së burokracisë, thjeshtimin e procedurave, reduktimin e kohës dhe kostove si dhe ofrimin e

shërbimeve të reja online. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si një nga institucionet më peshën dhe rolin kryesor në këtë reformë, ndërmoi një proces të deta-

DOKUMENTET QË MERREN 'ONLINE'

1. Certifikata e regjistrimit në QKB, përfshirë NIPT/NUIS
2. Ekstrakt historik i kompanisë
3. Vërtetim për posedim mjetesh
4. Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesit E-SIG 02a
5. Vërtetim për të ardhurat e realizuara në tre vitet e fundi për tender
6. Vërtetim për individ të paregjistruar
7. Formulari E-SIG03a - Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për individet
8. Vërtetim për përgjegjësinë tatimore
9. Vërtetim për pagimin e detyrimeve
10. Vërtetim për statusin e tatimpaguesit
11. Vërtetim për regjistrimin e investitorit tek Drejtoria Rajonale
12. Dëshmi penaliteti dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore
13. Të gjitha llojet e certifikatave që gjenerohen nga sistemi i gjendjes civile

juar të identifikimit të shërbimeve publike që ofrohen në sportelet e institucioneve të saj të varësishë, dokumenteve që kërkojnë për përfitim e shërbimeve dhe atyre që mund të eliminohen apo ofrohen online"-shkruan Ahmetaj.

FAZA E DYTË

Referuar letrës së ministrit mësohet se në fazën e dytë të reformës po ecet në dy drejtime kryesore. "Ne po avancojmë në dy korsi paralele, së pari, reduktimi i numrit të lejeve, licensave dhe autorizimeve të cilat

përbëjnë mbirregullim të tregut, për të cilat është përgatitur tashmë paketa e plotë e ndryshimeve ligjore dhe së dyti, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), po punojmë për ofrimin e shërbimeve të reja online, që përfshijnë pagesat elektronike në tatiime, autorizime të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, leje të punës dhe vërtetime të zyrave të punes etj"-shkruan Ahmetaj në letrën drejtuar bizneseve.

NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE 13 SHËRBIME PAGESASH DO TË OFROHEN 'ONLINE'

1. Pagesa online e taksës së TVSH të biznesit
2. Pagesa online e tatimit fitimit të biznesit
3. Pagesa online e tatimit të lojrave të fatit të biznesit
4. Pagesa online e tatimit mbi të ardhurat personale
5. Pagesa online e rentës minerare të subjektit
6. Pagesa online e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit
7. Pagesa online e taksave kombëtare
8. Pagesa online e tarifave kombëtare
9. Pagesa online e tatimit të mbajtur në burim
10. Pagesa online e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga biznesi
11. Detyrimet globale
12. Pagesa online e tatimit mbi të ardhurat nga punesimi nga biznesi
13. Pagesa online e tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël



LAJMËRIM PËR TENDER KUALIFIKIMI PARAPRAK

1. Kushtet e përgjithshme

- 1.1 Kërkuessit : Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë Adresa: Rr. Skënderbeg, Nr. 2/1
- 1.2 Profili : Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë që nga viti 1988 mbështet Shqipërinë në rrugën drejt Integritimit Europian dhe zhvillimit nëpërmjet projekteve që zbatohen në fushat: për Zhvillim Ekonomik, Reforma ligjore në ekonomi, Edukim dhe Kualifikim Profesional, Reforma në sektorin e ujësjellësit, dhe fusha të tjera.

- 1.3 Subjekti: GIZ fton Agjenci Udhëtimi të kualifikuara, anetare ne IATA të shprehin interes në sigurimin dhe menaxhimin e shërbimeve të udhëtimeve sipas kërkesave të Zyrës së administratës dhe të Projekteve të GIZ.

Profili i udhëtimeve të GIZ është kryesisht Tiranë - Gjermani - Tiranë, sipas nevojës dhe në vëndë të tjera.

- Të gjithë subjektet ligjore të interesuar në procesin e aplikimit duhet të kërkojnë një formë aplikimi në adresën: giz-albanien@giz.de
- 1.4 Data përfundimtare për pranimin e aplikimit të plotësuar në Anglisht është **26 Janar 2018**.

Dokumenti i plotësuar në mënyrë të saktë, duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur, të vulosur me mbishkrimin:

Aplikim për kualifikim paraprak "Menaxhim Shërbime Udhëtimi" adresuar tek

Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ), Zyra në Tiranë, Rr. Skënderbej, Nr. 2/1 Tiranë

Procesi i kualifikimit do të fillojë pas datës së mbylljes së aplikimit. Aplikimet do të vlerësohen dhe vetëm kandidatët e kualifikuar do të ftohen të marrin pjesë në tender.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,970,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas datave të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 09 Shkurt 2018, ora 09:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Flet kryetari i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, Nebil Çika

Ornela Manjani

Çika: Ish-të përndjekurit, qeveria heq dëmshpërblimin për 300 mijë persona

"Ndryshimet në ligj, trashëgimtarët rrezikojnë të humbasin të drejtën"

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë rrezikojnë të humbasin të drejtën e dëmshpërblimit. Janë në total rreth 300 mijë përfitues, që prej 27 vjetësh presin të marrin paratë, por ndryshimet në ligj që do diskuton nga qeveria mund të çojnë drejt përjashtimit të tyre nga përfitimi. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", kryetari i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, Nebil Çika, bën të ditur se ish-të përndjekurit nuk kanë një njoftim në lidhje me ndryshimet ligjore që po përgatit qeveria, të cilat u bënë të ditura dy ditë më parë nga ministri i Financave, Arben Ahmetaj, i cili njoftoi edhe bilokimin e fondit për pagesat e trashëgimtarëve. Sipas Çikës, shoqatës i është përcjellë për opionencë një projektligj nga Ministria e Drejtësisë, por në atë projekt pretendohen ndryshime në ligj në favor të të përndjekurve dhe jo kundër tyre si ky që po deklaroi tani ministri i Financave.

ditur Ministri Ahmetaj, është reduktimi i përfituesve të kompensimit. Si e komentoni ju këtë nisim të qeverisë?

Me sa duket po. Në fakt, ne na është përcjellë për opionencë një projektligj nga Ministria e Drejtësisë, por në atë projekt pretendohen ndryshime në ligj në favor të të përndjekurve dhe jo kundër tyre, si ky që po deklaroi tani ministri i Financave. Deri tani që nga viti 2013, qeveria ka përdorur një hile duke dëmshpërblyer vetëm të burgosurit e gjallë, që janë rreth 1000 persona, ndërkohe që trashëgimtarët janë shumë më shumë. Deri në vitin 2013 në Ministrinë e Drejtësisë ishin klasifikuar si status të përndjekuri politike me shumë se 25 mijë dosje të burgosurish apo të pushkatarish politikë nga komunizmi, trashëgimtarët e cilëve, fëmijë, nipër e mbesa shkojnë në rreth 300 mijë persona. Me pak fjalë, qeveria po synon që gjithë kësaj mase të përndjekur politikë t'i mohojë një të drejtë të garantuar deri tani me ligj. Kjo logjikë e politike në këtë pakt kriminalizues është po aq kriminale sa vrasjet, burgosjet e internimet e format e tjera të persekutimit në diktaturë. Ky vendim kriminalizues imoral i qeverisë "Rama" është një rikthim i pastër i luftës së klasave në bazë të urtërisë, që komunistët e trashëgojnë nga brezi në brez. Me vjen keq për ata pak bashkëvajtës që besuan te Rama dhe premtimet e tij. Tani besoj se të gjithë e kanë kapur që "çfarë lind nga macja, gjuan minj".

Pak ditë më parë ministri

Ministri i Financave deklaroi dje se është bllokuar fondi për pagesat e trashëgimtarëve të ish-të përndjekurve politikë. A jeni ju në dijeni të këtij fati? Si e komentoni këtë vendim?

Nuk kemi pasur asnjë njoftim zyrtar apo publik. U informuam nga deklarata e djeshme e ministrit të Financave dhe sigurisht u befasonam nga një vendim i tillë. Në buxhetin e ri qeveria ka planifikuar e miratuar rreth 19 milionë USD për të përndjekurit politikë, shifer që ne e kemi kontestuar si të pamjaftueshme. Në debatin për këtë çështje në komisionin parlamentar kam kërkuar që shumta të rritet dhe të përfshihen në kompensim edhe trashëgimtarët, pasi deri tani që nga viti 2013 askush prej tyre nuk është dëmshpërblyer nga kjo qeveri. Premtuan që do shikoheshin me përparësi kërkesat tona, por bënë të kundërtën dhe nuk e kanë për herë të parë një gjë të tillë. Më vjen keq, por me këtë vendim qeveria "Rama" vërtetoi dyshimet tona të bëra publike. Qëndrimi i tyre ndaj shtresës së të përndjekurve politikë tregon se ata kanë të njëjtin qëndrim me baballarët e tyre aktorë të krimeve të komunizmit. Përtej shpresës sonë për një meaculpa të partisë përgjegjëse për krime kundër njerëzimit dhe genocidit ndaj të përndjekurve politikë si dhe premtimeve elektorale të Edi Ramës, bijtë po dëshmojnë se janë aq armiqësorë sa edhe etërit e tyre politikë, juridikë e gjenetikë. Ky vendim është pa dyshim një kthim mbrapa në errësirën e diktaturës nga ana e qeverisë dhe një kambanë alarmi jo vetëm për të përndjekurit politikë, por për të gjithë shqiptarët.

Qeveria po shqyrton mundësinë për ndryshimin e ligjit të ish-të përndjekurve dhe ndryshimi i pritshëm, të cilin e bëri të



Kryetari i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë, Nebil Çika

trja e Drejtësisë tha se çdo ankesë dhe kërkesë e ish-të përndjekurve do të shihet me përparësi. A keni dijeni sa është numri i dosjeve që presin shqyrtim nga Ministria e Drejtësisë?

Përparësia e leshit! Po këta janë mashtrues të pacipë. Këtë ministria premtonte përparësi për dosjet e pa klasifikuar, ndërkohe që kolegu i saj thotë publikisht që do t'i ndërpresin fare kompensimet. Kam të gjithë të drejtën të besoj se ministria e dinte çfarë do të ndodhte dhe me paturpësinë më të madhe mashtroi publikisht viktimat e krimeve të të parëve të saj. Nuk ka ndonjë numër të përcaktuar, pasi sipas informacioneve, përpunimi vazhdon. Ka mbaruar vetëm afati i pranimit të kërkesave. Pra, tani me sa duket duan t'i fshijnë edhe ata që kanë përfituar statusin.

Si ka shkuar deri tani procesi i pagesave për kategoritë parësore?

Cila është kategoria parësore?! Vuajtja e dhimbja nuk ka përparësi, nëse me këtë

nënkuptoni të dënuarit direkt, po ju them se një fëmijë i internuar në kampet e shfarosjes së internimeve në Tepelenë apo Krujë ka vuajtur shumë më shumë se një i rritur i burgosur. Kush është ai bir... që përcakton me VKM përparësinë e dhimbjeve me, vuajtjeve dhe sakrificave. Këtu flitet për ligj dhe barazia para ligjit është e garantuar nga Kushtetuta.

A janë të mjaftueshme fondet që vë në dispozicion qeveria për pagesat e dëmshpërblimit?

Jo, sigurisht, e thashë edhe më lartë që e kemi kundërshtuar. Vetëm 19 milionë USD është qesharake, për më tepër që e kanë ngrirë edhe këtë fond. Sikur qeveria të jepte atë që ajo përfiton sot nga punët e papaguara të të burgosurve politikë, kompensimi duhet të kishte përfunduar me kohë. Aeroporti i Rinasit, Kuçovës, Gjadrit etj. janë ndërtuar me punë skllavëruese të të përndjekurve politikë. Ministrat kryesorë të vendit, kënetat, Maliqi, Tërbufi, Bedeni,

Torrovica etj. janë tharë e bërë fusha nga puna e papaguar e detyrueshme në kushte skllavërie të të burgosurve politikë, pa llogaritur këtu uzinën e përpunimit të Naftës në Ballsh etj., palate në të gjithë vendin të ndërtuar nga të burgosurit politikë. Sikur vetëm ajo që shteti merr çdo vit nga koncesioni i Aeroportit të Rinasit të përdoret për kompensimin e të përndjekurve politikë do të ishte drejt përfundimit. Sipas një raporti të KLSH-së të vitit 2016, me ritimin që qeveria do dëmshpërblen të përndjekurit do të duhen të paktën 16 vjet për ta përmbyllur këtë proces.

Çfarë masash do të marrë shoqata për të penguar vendimin e qeverisë për zvogëlon e numrit të përfituesve? A keni ju një shifer sa mund të jeni numri i trashëgimtarëve që mund të humbin të drejtën e dëmshpërblimit?

Nuk bëhet fjalë për zvogëlim, por për mohim, shkelje të një ligji, të një të drejte të mohuar, të shkelur si në kohën e diktaturës. Ka një shkelje flagrante të barazisë para ligjit, një shkelje të të drejtave themelore të njeriut edhe në këtë lloj kompensimi që bëhet deri tani. Nëse sot një i dënuar shpallë ia pajafshëm, ai kompensohet menjëherë me të gjithë shumën nga shteti. Shuma e ia dëmshpërblimit është dyfish më e madhe se e një të burgosuri apo të pushkatarit politik, i shpallur gjithashtu i pajafshëm. Ndryshimi është i dukshëm, ata që janë dënuar në diktaturë në kushte të rënda të torturës dhe dhunës së paparë dis-

kriminohen si në shumën që dëmshpërblehen, edhe në kohën që u jepet, me këste, madje tani duan tua heqin fare. Ndërkohë, ata që janë dënuar pa faj në demokraci, kushte komode hetimi e izolimi shpërblehen dy herë më shumë për ditë burgu dhe i marrin në dorë të gjitha partë, pa këste. Shembulli me kriminelin është dëmshpërblimi i drejtuesve të lartë të diktaturës dhe Sigurimit të Shtetit të dënuar në vitin 2005 për genocid. Kur kjo parti e Edi Ramës dhe Arben Ahmetajt edhe në pushtet në 2008-ën i shpalli ata të pajafshëm dhe u dha në dorë partë e dëmshpërblimit dy herë më shumë se sa viktimat e tyre të pushkatuar e të dënuar politikë. Ky është standardi i luftës së klasave, që kjo qeveri komuniste ka përdorur e po përdor ndaj të përndjekurve politikë të komunizmit. Ky është edhe standardi i vërtetë i pothuaj demokracisë dhe shtetit pothuaj ligjor shqiptar. Sigurisht që do reagojmë me të gjithë forcën tonë, me të gjitha mjetet e mënyrat në dispozicion. Por tani në emër të të përndjekurve politikë po i them Edi Ramës që të mos luajë me zjarrin e të vazhdojë rrugën e babit të vet me kundërshtarët politikë të komunizmit. Nuk kam pretenduar nga ia t'i vijë keq për pasardhësit të Havzi Nelës apo të tjera viktimat të të atit, por ky kthim në luftën e klasave nuk mund të tolerohet për asnjë arsye. Është një lumë gjaku midis nesh. Kam thënë edhe herë të tjera që Shqipëria është në luftë të ftohtë civile, por me këto veprime qeveria po provokon ta bëjë atë të ngrohtë.

Ndërprerja e dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit, Basha: Akt i papranueshëm i dyshes Rama-Ahmetaj

Mbrëmjen kësaj të martë, kreu i PD-së, Lulzim Basha ka shpërthyer në akuzat kundër kryeministrit Edi Rama dhe ministrit të Financave, Arben Ahmetaj, pas deklaratës së këtij të fundit se do të ndërpritet fondi për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë. Në një takim në mbrëmje me disa degë të PD në Tiranë, Basha e cilësoi të papranueshëm planin e qeverisë "për të hequr familjarët e ish-të përndjekurve politikë nga e drejta e ligjshme



Foto ilustruese

dhe morale e dëmshpërblimit". Kreu i PD theksoi se opozita nuk do ta lejojë çika të tillë dhe se do të qëndrojë kundër çdo përpjekjeje të qeverisë për heqjen e

dëmshpërblimit. Mes të tjerave, Basha u bëri thirrje familjeve të ish-të përndjekurve dhe pronarëve të bashkohen me opozitën në 27 janar.

Çupi: Qeveria po mohon të drejtën e ish-të përndjekurve

Deputetja e PD, Dhurata Çupi komentoi deklaratën e ministrit të Financave, Arben Ahmetaj për heqjen nga skema e përfitimit të trashëgimtarëve të ish-të dënuarve politikë. "Kjo qeveri po shkon sipas programit të etërve të regjimit komunist. Partia bijë në pushtet i trajton në të njëjtën mënyrë ata, që prej më shumë se 70 vitesh mendojnë ndryshe nga regjimi i tyre. Ministri i parave të shqiptarëve do të hiet kompensimi për trashëgimtarët e ish-të përndjekurve politikë. Ka të drejtë ministri oligark se është në përmbyllje të mendësise së regjimit që simbolizon partia e tij. Nuk mundet që partia, bijë e asaj që i dënonë duke i vrrarë, ekzekutuar e internuar që t'i dëmshpërblejë për gjakun e dhimbjen që u shkaktoi vetë regjimi komunist. Ai regjim që ia trashëgimi Partinë Socialiste, sot në pushtet me votat e tjetërsuara të shqiptarëve. Kjo qeveri jo vetëm që nuk kujdeset për këtë kategori të përndjekur për gjysmë shekulli, por vijon të përndjekë bijtë e tyre edhe sot e kësaj dite. Kjo qeveri ka vendosur t'u mohojë atë që u takon me ligj, por edhe me moral qindra familjeve të persekutuar përgjatë 50 viteve komunizëm", - shkruan Çupi në 'FB'.

DËSHMIA/ Ne e ndihmuam për 'Vollgën', u habita kur mësova se na kishte kallëzuar

Gilmano Dani në gjyq: Ylvi Beqja ma prezantoi Shullazi në shtëpinë e tij

"Me kërkesë të biznesmenit tërhoqa para në bankë"

TIRANË

Gilmano Dani, krahu i djathtë i Emiljano Shullazit ka mohuar dhe akuzat e prokurorisë për gjobënie ndaj biznesmenit Ylvi Beqja. Gjatë seancës së radhës së zhvilluar në Gjykatën për Krimet e Rëndë dhe që zgjati afro një orë, i arrestuari si pjesë e grupit kriminal tha se me Beqjan ka pasur marrëdhënie të mira dhe komunikonte vazhdimisht. Madje theksoi se ai dhe miqtë e tij i kanë dhënë ndihmë për të regjistruar ish-hotel "Vollgën" në Hipotekë.

"Ylviun ma prezantoi Emiljano Shullazi në shtëpinë e tij. Ai kërkonte ndihmë, pasi ndihet i kërcënuar nga Zamir Hasa, i cili pretendonte pronësinë e ish-hotel "Vollgës". Problemi tjetër që kishte, lidhej me procedurat



Gilmano Dani

burokratike për regjistrimin e pronës në Hipotekën e Durësit", u shpreh Gilmano Dani. Ndërkaq, ai pranoi se ka tërhequr nga bankat e nivelit të dytë disa çeqe, por e ka bërë me kërkesën e vetë biznesmenit, që mban statusin

e të pënduarit të drejtësisë. "Ylviu më kërkoi të tërhoqja disa çeqe në bankë. Më thoshte tërhoqi paratë, pasi nuk dua që këtë fakt, ta mësojnë edhe bashkëpronarët e tjerë. Çdo qindarkë ia kam dhënë në dorë. Madje, ai më

ka edhe 2 mijë euro borxh. Me kërkesën e tij kanë tërhequr çeqe edhe Endrit Qyja dhe Endrit Zela. Njëherë, Qyja tërhoqi 16 mijë euro, që u përdoren për një faturë në hipotekën e Durësit", u shpreh Dani. Por, përkundër nga sa deklaroi ai, prokuroria thotë se Ylvi Beqja u pagoi të pandehurve në formën e gjobave shumë prej 500 mijë eurosh. Në vijim Dani tha se u surprizua, kur pas arrestimit mësoi se ishte pikërisht Ylvi Beqja, njeriu që i kishte kallëzuar për gjobënie. Ai mohoi gjithashtu të kishte gisht në kërcënimin e Mynyr Konit e Dhori Kules. Një seancë më parë, Shullazi hodhi poshtë akuzat e prokurorisë. Në seancën e djeshme mungoi Emiljano Shullazi, ndërsa tre të pandehurit e tjerë nuk dhanë pëlqimin për t'u marrë në pyetje.



Vrasja në Vlorë, Memaj e ftoi në kafe, Artjon Shenaj e qëllloi me 7 plumba

Vlorë - Vrasja e 35-vjeçarit Mariglen Memaj dhe më pas vetëvrasja e autorit të krimit, Artjon Shenaj ka tronditur banorët e Gjormit në Vlorë. I gjithë fshati është në zi, ndërsa dy familjet kanë hapur dyert e mortit. Dëshmitarët e ngjarjes së ndodhur mbremënjë e së hënës kanë pohuar se 33-vjeçari Shenaj është fuar nga Mariglen Memaj që të ulet në tryezën ku ai dhe një grup të rinjsh po pinin rreth sobës. Mësohet se Shenaj nuk ka pranuar që të ulej në të njëjtën tavolinë me shokun e tij. Ai ka qëndruar pak çaste në lokal dhe më pas ka dalë dhe ka shkuar në banesën e tij nga ku është kthyer me pistoletë në dorë. 33-vjeçari i ka drejtuar armën Memaj (baba i dy fëmijëve), ndërsa u ka kërkuar të tjerëve që të largohen dhe e ka qëlluar 7 herë. Pak minuta më vonë (100 m larg lokalit), të shtëpia e xhaxhait të tij, Artjon Shenaj kreu vetëvrasje me të njëjtën armë. Sipas burimeve nga policia, dyshohet që kjo ngjarje mund të ketë lidhje me një konflikt të hershëm, pasi të dy personat në fjalë kanë qenë jashtë shtetit vite më parë. Ndërsa mësohet se Artoni ka qenë në burg në Francë për 8 muaj dhe kishte 3 ditë që ishte kthyer në fshatin Gjorm. Ai jetonte me nënën dhe vëllain. Ndërkaq, policia po punon intensivisht për zbardhjen e plote të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Hetuesit e çështjes kanë marrë në pyetje të afërm dhe miqtë e të dy personave, ndërsa po heton për aktivitetin e tyre jashtë vendit, pasi që të dy të rinjtë prej vitesh jetonin jashtë Shqipërisë. Pas vrasjes së Mariglen Memaj dhe vetëvrasjes së autorit, blutë e Vlorës dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSh) kanë zbuluar në fshatin Gjorm për të parandaluar një përshkallëzim të mundshëm të konfliktit mes dy familjeve.

Sherbime Konsulente (Sektori I Gjenerimit Hidrik -Rehabilitim/Modernizim) Afati I fundit: 12 Shkurt 2018 (Ora 16:00)

VENDI: Albania

REFERENCA NR.: BMZ ID 2009 66 531

FTSE PER TENDER: Tender I hapur ndërkombëtar me parakualifikim

REF: Sherbime Konsulente per Konsulent Zbatim per Qendren Dispecer e te Monitorimit te Digave per Hec-et e Kaskades se lumit Drin.

AGJENCIA E ZBATIMIT TE PROJEKTI: KESH - Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare sh.a.

MASAT NDERHYRESE TE PROJEKTI:

(i) Nje Program i Sigurise se Digave - nen implementim: pershin investime te ndryshme te fokusuara ne sigurine e digave dhe ne Hec-et ne kaskaden e lumit Drin. Pjesa e ketij Programi eshte edhe implementimi i Qendres Dispecer e te Monitorimit te Hec-eve te Kaskades se lumit Drin (DMDC). Projekti I propozuar pershin punesimin e nje konsulentit zbatim per DMDC.

Ne kuadrin e Programit, nje konsulent tjetër ka perfunduar studimin e fizibilitetit per Qendren ne fjale. Objektivt i Sherimit te Konsulences eshte te siguroje sherbim profesional, te plote dhe gjithepershires duke asistuar PMU ne KESH ne zbatimin e Projektit, neperjet:

(i) Perpunimi i projektit paraprak te Qendres Dispecer e te Monitorimit (DMDC),
(ii) Pergatitja e Dokumentave te Tenderit per kontraktimin.
(iii) Asistence ne procesin e prokurimit bazuar ne udhezuesin e prokurimit te KIW si dhe ne Librin e Verdhe te FIDIC.
(iv) Negocimi dhe menaxhimi ne menyren me te perfuturshme te kontrates per implementimin e DMDC
(v) Mbrojtja e punimeve dhe asistence per PMU me qellimin e arrijtes se nje cilesie optimale te punimeve dhe mallrave me koston me te arsyeshme dhe periuhen e zbatimit me te shkurter te nevojshme..

FINANCIAR: Bashkepunimi Financiar Gjerman neperjet Bankes se Zhvillimit KfW.

SHERBIMET E KERKUARA TE KONSULENCES:

Konsulentit do te siguroje asistence per KESH-PMU ne aktivitetet qe i perkasin zbatimit te projektit. Objekti i punes pershin si me poshte:

1. Sherbime te parandertimit, pershire pergatitjen e projektit paraprak te punimeve si dhe procesin e tenderimit per DMDC.
2. Asistence ne Menaxhimin e Projektit.
3. Rishikimi i dokumentacionit te leshuar nga Kontraktori.
4. Mbrojtja e Kontraktorit ne vendin e zbatimit te Projektit.
5. Monitorimi i Sistemit te Shendetit dhe te Sigurise dhe Plani I Mbrojtjes se Mjedisit te Kontraktorit.
6. Inspektimi i vendit te prodhimit te komponenteve kryesore.
7. Asistence ne korrigjimin e mangesive gjate periuhen se garancise se difekteve.
8. Raportim.

Punimet qe do te kryhen ne kuadrin e Projektit jane komplekse dhe kerkojne nje experience nderdisiplinore ne fushat e meposhtme te inzhinierise:

- Kontrolli Dixhital, Mbrojtje dhe Matje (Menaxheri I Projektit),
- Telekomunikacion dhe SCADA (Ekspert),
- Elektrik/Mekanik,
- Gjeologjij/ Sizmike ,
- Hidrologji/Hidroteknike
- Nderitim/Topografi,
- Prokurim, Finance dhe Administrate Kontrate
- Komisionim/Kontroll Cilesie
- Menaxher i sistemeve te shendetit sigurise dhe mjedisit

Menaxheri I Projektit duhet te kete te pakten 15 vjet experience profesionale ne projekte te ngjashme. Specialistet e tjerë duhet te kene te pakten 10 vjet experience profesionale ne fushat e kerkuara. Sherbimet e konsulences do te vazhdojne per nje periudhe 18 mujore. Konsulentit do te punoje ngushte me counterpartin e tij lokal ne PMU. Sherbimi do te kryhet kryesisht ne Shqipëri (Tiranë dhe ne vendet e Projektit gjate fazes se zbatimit te punimeve). Ky parakualifikim per sherbimet e konsulences do te kryhet ne perputhje me versionin e fundit te "Udhezuesit per Punesimin e Konsulenteve ne Bashkepunimin Financiar me Vendet Partnere" (referojuni faqes se internetit te Bankes per Zhvillim KfW (www.kfw-entwicklungsbank.de). Parashikohet qe sherbimet e konsulences ti jepen nje firme konsulente te pavarur qe ka marrë pjesë ne projekte rehabilitimi dhe modernizimi te HEC eve dhe me experience te thelle ne projektim dhe operim te sistemeve te SCADA es dhe preferohet ne Europe. Xhoroja vjetore per te vjetet e fundit te mos jete me e vogel se 1.5 milion euro. Flessa per Shprehetje e Interesit do te kerkohet ne KESH - Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare sh.a. ne adresen e meposhtme:

KESH:Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare sh.a. ("KESH")
Drejtuar Mr. Fatos Bundo (Drejtori I Projekteve)
Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri
Albania
Tel/Fax : +355 4 2262148
Cel +355 69 40 42 518
E-mail : bundof@kesh.al

Consulting Services (Hydropower Sector -Rehabilitation/Modernization) Deadline: 12 February 2018 (16:00 hours CET)

COUNTRY: Albania

REFERENCE NO.: BMZ ID 2009 66 531

INVITATION TO TENDER: International competitive bidding with pre-qualification

REF.: Consulting Services for an Implementation Consultant for the Dam Monitoring and Dispatch Center (DMDC) for Drin River Cascade HPPs.

PROJECT EXECUTING AGENCY: KESH - Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare sh.a. (Albanian Power Corporation)

PROJECT MEASURES:

A Dam Safety Programme - under implementation - comprises various investments focusing on hydropower and dam safety in the Drin river cascade. Part of the Programme is the implementation of a Dam Monitoring and Dispatch Centre (DMDC) for the Drin River Cascade HPPs. The proposed Project includes appointing of an implementation consultant for the DMDC. In the framework of the Programme another consultant carried out the feasibility study for the envisaged DMDC. The objective of the Consulting Services for the Project is to provide complete, comprehensive and professional services by assisting the Project Management Unit (PMU) of KESH in the implementation of the Project by:

- (I) Elaborating the Preliminary Design for the DMDC,
- (II) Preparing of the Tendering Documents (TD) for the contract.
- (III) Assisting the procurement process of the based on the procurement guidelines of KfW and based on FIDIC Yellow Book (IV) Negotiating and managing in the most profitable way the contract for implementation of DMDC
- (V) Supervising the works and to assist the PMU aiming on optimal quality of the works and goods at the most reasonable costs and the shortest necessary implementation period.

FINANCING: German Financial Cooperation through KfW Development Bank

REQUESTED CONSULTING SERVICES:

The Consultant will provide assistance to KESH-PMU in activities pertaining to the implementation of the Project. The Scope of Works will be the following:

1. Pre-construction services, including the preparation of preliminary design works as well as tendering process for the DMDC.
2. Assistance in Project Management.
3. Reviewing of Contractor's output.
4. Supervision of Contractor's works at site.
5. Monitoring Contractor's Health and Safety System and Environmental Protection Plan.
6. Inspections at Manufacturer's site of main components.
7. Assistance to correct all deficiencies within the Defects Liability Period.
8. Reporting.

The works to be performed in the framework of the Project are complex and require interdisciplinary experience in the following fields of engineering:-

- Digital Control, Protection and Metering Engineering Expert (Project Manager), .
- Telecommunications and SCADA Expert, .
- Electrical/Mechanical Expert, .
- Geologist/ Seismic Expert, . Hydrology/ hydro-technical Expert, .
- Civil/Survey engineering Expert, .
- Procurement, Finance and Contract Administration Expert, .
- Commissioning/Quality Control Expertise, .
- HSE Manager

The Project Manager shall have at least 15 years of professional experience in similar projects. The other specialists must have at least 10 years of professional experience in the requested fields. The Consultant's Services shall continue for a period of 18 months. The Consultant will work closely with his local counterparts in the PMU. Services will be carried out mainly in Albania (Tirana and at the Project sites during the implementation phase).

This prequalification for consulting services will be guided by the latest version of the "Guidelines for the Assignment of Consultants in Financial Cooperation with Partner Countries" (refer to the home page of KfW Development Bank www.kfw-entwicklungsbank.de). It is foreseen to assign the services to an independent consultant firm having participated in modernization and rehabilitation of HPP and with profound experience in the design and operation of SCADA systems preferably in Europe. The minimum annual turnover shall be not less than EUR 1.5 million for the last 3 years. The Invitation for Expression of Interest will be made available upon request by Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare sh.a. (KESH) under the following address:

KESH:Korporata Elektroenergjitiqe Shqiptare sh.a. ("KESH")
Att.: Mr. Fatos Bundo (Head of PMU)
Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri
Albania
Phone : +355 4 2262148
Mobile +355 69 40 42 518
Fax : +355 4 2262148
E-mail : bundof@kesh.al

Voltiza Duro

Kaos nëpër konsultore, mjekët lajmërojnë nënat e reja të vaksinonjë të vegjlit

Rikthehet fruthi, 11 fëmijë të shtruar ISHP, hesht: Po përgatishim raportin

Familjarët: Shërbim mizerje, disa mjekë kërkojnë lekë

Sëmundja e fruthit është rikthyer sërish në vendin tonë pas shumë vitesh. Në pavionin e Pediatrisë Infektive në QSUT janë shtruar deri më tani 11 vogëlushë të prekur, ndërkohe që ende nuk ka një deklaratë zyrtare nga instancat përkatëse nëse ky është një rast epidemie apo jo. Të pyetur nga "Gazeta Shqiptare", burime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bëjnë me dije se po priten rezultatet e raportit të Institutit të Shëndetit Publik. Ndërkaq, ky i fundit në një prononcim për "GSH" thekson se specialistët e këtij institucioni po monitorojnë situatën e së shpejti do të ketë një raport përfundimtar mbi situatën. Ndërkohë që mjekët e pediatrisë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" nuk pranojnë të prononcohen mbi numrin e fëmijëve të prekur nga fruthi e vijimësinë e rasteve të sëmurura. Megjithatë konsultoret e lagjeve pas lajmit për epidemi fruthi kanë marrë në telefon nënat e reja dhe i kanë kërkuar të vaksinonjë me urgjencë fëmijët ose në rast të kundërt do e mbanin përgjegjësinë vetë nënat për të vegjëlit e tyre. Kjo është një tjetër situatë kaotike ku nuk ka asnjë shprehje zyrtare nëse ka apo jo epidemi e në rast epidemie vaksinimi është totalisht i palejuar sepse



Pediatria Infektive

mund të sjellë edhe vdekje të foshnjeve. **REAGIMI I FAMILJARËVE** Ndërkohë në Pediatrinë Infektive gjejmë të shtruar disa fëmijë, të shoqëruar nga familjarët e tyre. "Djali im është 10 muajsh e ende mjekët

nuk na kanë dhënë një përgjigje përfundimtare. Na thanë që mund të ketë fruth, por Instituti i Shëndetit Publik po merret akoma me analizat. Deri atëherë jemi në pritje. Ne nuk e kishim vaksinuar fëmijën, se vaksina bëhet mbi 1 vjeç", - tregon

REAGIMI I NËNË

"Djali im është 10 muajsh dhe ende mjekët nuk na kanë dhënë një përgjigje përfundimtare. Na thanë që mund të ketë fruth, por Instituti i Shëndetit Publik po merret akoma me analizat. Deri atëherë jemi në pritje. Ne nuk e kishim vaksinuar fëmijën, se vaksina bëhet mbi 1 vjeç", - tregon nëna e foshnjës për "Gazeta Shqiptare".

nëna e foshnjës për "Gazeta Shqiptare". Ndërkohë një prej familjarëve, i revoltuar hedh akuzë drejt mjekëve për marrje parash kundrejt shërbimit. "Këtu të shikojnë vetëm për të marrë lekë e as duan t'ia dinë. Ka edhe mjekë e infermierë të mirë, por ka edhe mizerje, që s'të prekin me dorë fëmijën por s'iu mbushe xhepin. Mjerë këto foshnja e mjerë e ardhmja e këtij vendi", - rrëfen një nga familjarët e foshnjës për "Gazeta Shqiptare". Sipas burimeve konfidenciale, 11 fëmijët e vegjël të prekur nga fruthi janë të

pavaksinuar, edhe pse disa prej tyre kanë kaluar moshën 1 vjeç, çka përkon edhe me moshën kur duhet bërë vaksina. Por mesa duket, shtyrja apo refuzimi nga ana e prindërve ka bërë që këta fëmijë të preken nga fruthi. Në një prej dhomave të Pediatrisë Infektive të QSUT-së gjendet një tjetër vogëlush me fruth, edhe ky i paizoluar në karantinë. "Fëmija im është me fruth, por nuk mund të flas, se jam edhe vetë e sëmurë me grip", - thotë nëna e re për "GSH". Deri më tani mendohet se ka qenë një fëmijë

i paraqitur për vizitë mjekësorë në urgjencën e pediatrisë i prekur nga ky virus, çka ka infektuar edhe fëmijët e tjerë që kanë qenë prezent atë ditë. Edhe pse prej më shumë se 30 vitesh, kjo sëmundje konsiderohet e zhdukur, fruthi është rishfaqur sërish në Shqipëri. Faktori kryesor për mosvaksinimin e fëmijëve u bë "alarmi" i shkakuar dy vite më parë në disa portale të huaja, ku shkruhej se vaksina kundër fruthit mund të shkaktojë autizëm tek vogëlushët 1-vjeçarë. Sipas statistikave, rezultojnë të pavaksinuar edhe fëmijë të komitetit me ngjyrë si dhe ata që i kanë prindërit fetarë dhe që e refuzojnë hapur vaksinimin. Një i sëmurë me fruth arrin të infekttojë 12 persona të tjerë, ndërkohe që sëmundja fillon si grip, por mund të shkaktojë edhe vdekjen.

Protestë në 24 janar/ Pedagogu: Të mos paguhen dyfish kreditet për provimet e mbartura

Kundër tarifave të larta, 4 mijë studentë nënshkruajnë peticionin

Mbi 4 mijë studentë, kryesisht nga Universiteti i Tiranës, por edhe nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minerave të Politeknikut, kanë nënshkruar peticionin kundër tarifave të larta të studimit. Përkatesisht, nëpërmjet këtij peticioni kërkohet përgjysmimi i tarifave studimore në të gjitha degët e nivelet, mospagimi dyfish i krediteve për provimet e mbartura si dhe heqja e barrës financiare për certifikimin e gjuhës së huaj. Lëvizjes studentore "Për Universitetin" i janë bashkuar edhe shumë pedagogë. I pyetur nga "Gazeta Shqiptare", pedagogu i Shkencave të Natyrës në UT, Jani Marka tregon se prej nëntorit janë zhvilluar shumë tryeza diskutimi mbi problematikat që prekin studentët, pedagogët e universitetin në tërësi. "Tarifat e studimit në Shqipëri janë më të lartat, në vlerë absolute, krahasuar me të gjitha vendet fqinje. Në këto kushte, prej vullnetit të tryezave u vendos që në muajin janar të ngrihej një fushatë e gjerë për përgjysmimin e tarifave të studimit në të gjitha nivelet e studimit, pasi ato konsiderohen të padrejta e të papërbal-



Studentë duke firmosur peticionin



Peticioni

lueshme për studentët e familjet e tyre, por edhe e kthejnë studentin në klient financiar të universitetit", - thotë Marka. Ky i fundit thekson se në këtë fushatë do të kërkohet heqja e kushitit për të certifikuar gjuhën e huaj në institucione private, të cilat aplikojnë një tarifë të lartë fitimprurëse në dëm të studentëve. Gjithashtu, pedagogu thotë se do të kërkohet heqja e rregullit absurd që i gjobit studentët përsëritës të vitit të fundit me një tarifë

dyfish më të lartë për do kredit krahasuar me tarifat e zakonshme. "Për çdo provim që japin studentët të kësaj kategorie duhet të paguajnë rreth 20,000 lekë të reja. Ndërsa në Fakultetin Gjeologjik Miniera, përveç kërkesave ekonomike, ka edhe një çështje tjetër madhore, siç është ajo e godinës së fakultetit, të cilën qeveria prej disa vitesh kërkon ta tjetërsojë në pallat drejtësisë", - shton Marka për GSH. Kërkesat e studentëve i drejtohen qeverisë, ndërkohe

që Fakulteti i Gjeologji-Minerave ka nënshkruar edhe një peticion të dytë mbi rikthimin e godinës së fakultetit në pronësi të tij. Nën thirrjen "Bashkohu", të rinjtë shprehen se nënshkrimi i peticionit do të vazhdojë e do të kulmojë me protestën në datën 24 janar të këtij viti para Kryeministrit. Në muajin nëntor dhe dhjetor lëvizja "Për Universitetin" ka zhvilluar një sërë tryezash, me studentët e pedagogët, për problematikat që prekin stu-

dentët, pedagogët dhe universitetin në tërësi. Më konkretisht, këto diskutime janë zhvilluar në Fakultetet e Shkencave Sociale, të Gjuhëve të Huaja, të Shkencave të Natyrës dhe atë Ekonomik të Universitetit të Tiranës, si dhe në Fakultetin Gjeologjik Miniera të Universitetit Politeknik. Gjatë takimeve, studentët kanë ngritur shumë shtetësi, por ato që ishin më urgjente, e të përbashkëta për të gjithë, ishin ato të kushteve ekonomike. **vo.ðu.**

PEDAGOGU

TARIFA TË PAPERBALLUESHME "Tarifat e studimit në Shqipëri janë më të lartat, në vlerë absolute, krahasuar me të gjitha vendet fqinje. Në këto kushte, prej vullnetit të tryezave u vendos që në muajin janar të ngrihej një fushatë e gjerë për përgjysmimin e tarifave të studimit në të gjitha nivelet e studimit, pasi ato konsiderohen të padrejta e të papërbalueshme për studentët e familjet e tyre", - tregon pedagogu Marka për "GSH".



Ministria e Shëndetësisë: Aplikoni nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë"

Afati i fundit i aplikimeve për 416 vende të lira pune në mjekësi

Udhëzimi, dokumentacioni që duhet të dorëzoni



Voltiza Duro

Deri më datën 1 shkurt të këtij viti, të gjithë të interesuarit që përbushin kriteret mund të aplikojnë për pozicionet e lira të punës në disa prej degëve të mjekësisë. Respektivisht, janë 416 vende vakante në infermieri/ mami, fizioterapi/ logopedi dhe teknik imazherie apo laborator. Sot, në "Gazeta Shqiptare" publikohet numri i pozicioneve të lira në secilin degë në bazë qarku. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bën me dije se fituesit, pas konkurrimit do të kenë mundësi të punojnë në një qendër shëndetësore apo një spital publik në vend. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) shpall datën e fillimit të aplikimeve për pozicionet vakante. Të interesuarit do të kenë si afat për kryerjen e aplikimit online nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë" 3 javë kalendarike nga data e shpalljes", thuhet në udhëzimin e firmosur nga Ogerta Manastirliu. Të gjithë kandidatët e interesuar për të punuar si profesionistë të shkencave mjekësore teknike në një nga institucionet përkatëse publike, duhet të marrin pjesë në konkurrimin, i cili do të kalojë në 3 faza. Përkatesisht, faza e parë konsiston në konkurrimin me dosje, e dyta në testimin me shkrim dhe faza e tretë në zgjedhjen e vendit të punës.

DOKUMENTACIONI

Ndërkaq, të interesuarit duhet të jenë të kujdesshëm që gjatë fazës së parë të konkurimit, të ngarkojnë të gjithë dosjen me dokumentacionin e kërkuar në portalin "Infermierë për Shqipërinë". Respektivisht duhet të dorëzohet curriculum vitae (CV), një raport mjekoligjor i tre muajve të fundit, deklaratë për gjendjen



Foto ilustruese

gjyqësore si dhe një fotokopje e noterizuar e diplomave dhe listës së notave për secilin prej tyre. Më tej, në udhëzimin citohet se gjatë fazës së parë të konkurimit, duhet të dorëzohet edhe një fotokopje e noterizuar e lejes së ushtrimit të profesionit të infermierit, një fotokopje e librezës së punës, certifikatat e pjesëmarrjes për aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda apo jashtë vendit si dhe një fotokopje të noterizuar të dëshmive të kualifikimeve shkencore dhe dëshmive të njohjes së gjuhëve të huaja. Së fundmi, aplikantit do i nevojitet edhe një deklaratë për autorizimin e institucionit shëndetësor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura. Pas aplikimit do të bëhet vlerësimi i dosjes nga Komisioni i Vlerësimit të qarkut përkatës, i cili do të rendisë kandidatët sipas pikëve të grumbulluara. Rezultatet do të publikohen në portalin

416

VENDE TË LIRA PUNE

Respektivisht janë 416 vende vakante në infermieri/ mami, fizioterapi/ logopedi dhe teknik imazherie apo laborator. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bën me dije se fituesit, pas konkurrimit do të kenë mundësi të punojnë në një qendër shëndetësore apo një spital publik në vend.

"Infermierë për Shqipërinë" duke filluar nga kandidati me më shumë pikë, çka do të përcaktojë edhe fituesit e vendeve të punës.

POZICIONET E LIRA PËR INFERMIER / MAMI

Vendet vakante	Qendra Shëndetësore Bashkia	Qarku
3 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Lushnjë	Qarku Fier
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Divjakë	Qarku Fier
3 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Lushnjë	Qarku Fier
3 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Fier	Qarku Fier
2 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Sarandë	Qarku Vlorë
6 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Fier	Qarku Fier
4 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Përmet	Qarku Gjirokastrë
5 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Patos	Qarku Fier
3 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Roskovec	Qarku Tiranë
39 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Tiranë	Qarku Gjirokastrë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Tepelenë	Qarku Vlorë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Delvinë	Qarku Gjirokastrë
2 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Gjirokastrë	Qarku Vlorë
2 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Vlorë	Qarku Gjirokastrë
2 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Këlcyrë	Qarku Durrës
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Krujë	Qarku Lezhë
2 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Kurbin	Qarku Durrës
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Durrës	Qarku Gjirokastrë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Libohovë	Qarku Shkodër
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Pukë	Qarku Shkodër
2 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Shkodër	Qarku Gjirokastrë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Tepelenë	Qarku Gjirokastrë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Pogradec	Qarku Korçë
7 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Korçë	Qarku Korçë
3 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Kolonjë	Qarku Korçë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Devoll	Qarku Vlorë
3 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Delvinë	Qarku Elbasan
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Peqin	Qarku Vlorë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Gramsh	Qarku Vlorë
2 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Finiq	Qarku Elbasan
2 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Elbasan	Qarku Tiranë
2 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Vorë	Qarku Durrës
4 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Shijak	Qarku Tiranë
26 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Tiranë	Qarku Berat
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Berat	Qarku Tiranë
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Kavajë	Qarku Durrës
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Krujë	Qarku Vlorë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Konispol	Qarku Tiranë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Rrogozhinë	Qarku Durrës
12 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Durrës	Qarku Dibrë
4 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Sarandë	Qarku Vlorë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Selenicë	Qarku Tiranë
3 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Kamëz	Qarku Dibrë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Klos	Qarku Vlo
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Vlorë	Qarku Shkodër
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Vau i Dejës	Qarku Shkodër
7 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Shkodër	Qarku Shkodër
3 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Mirditë	Qarku Lezhë
9 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Pukë	Qarku Shkodër
15 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Dibrë	Qarku Dibrë
11 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Lezhë	Qarku Lezhë
4 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Bulqizë	Qarku Dibrë
10 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Malësi e Madhe	Qarku Shkodër
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Pustec	Qarku Korçë
8 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Kurbin	Qarku Lezhë
16 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Pogradec	Qarku Korçë
4 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Fushë-Arrëz	Qarku Shkodër
7 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Tropojë	Qarku Kukës
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Has	Qarku Kukës
8 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Maliq	Qarku Korçë
8 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Korçë	Qarku Korçë
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Kolonjë	Qarku Korçë
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Devoll	Qarku Korçë
5 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Prrerjas	Qarku Elbasan
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Peqin	Qarku Elbasan
2 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Librazhd	Qarku Elbasan
5 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Gramsh	Qarku Elbasan
14 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Elbasan	Qarku Elbasan
4 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Cërrik	Qarku Elbasan
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Belsh	Qarku Elbasan
6 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Ura Vajgurore	Qarku Berat
11 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Skrapar	Qarku Berat
5 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Polican	Qarku Berat
9 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Kuçovë	Qarku Berat
11 vende vakante	ne Qend. Shendet. Bashkia Berat	Qarku Berat

POZICIONET E LIRA PËR FIZIOTERAPIST / LOGOPED

Vendet vakante	Qendra Shëndetësore Bashkia	Qarku
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Kukës	Qarku Kukës
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Përmet	Qarku Gjirokastrë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Elbasan	Qarku Elbasan

POZICIONET E LIRA PËR TEKNIK IMAZHERIE / LABORATORI

Vendet vakante	Qendra Shëndetësore Bashkia	Qarku
1 vend vakant	ne Qend. Shendet. Bashkia Vorë	Qarku Tiranë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Has	Qarku Kukës
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Vlorë	Qarku Vlorë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Delvinë	Qarku Vlo
2 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Fier	Qarku Fier
9 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Tiranë	Qarku Tiranë
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Korçë	Qarku Korçë
2 vende vakante	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Librazhd	Qarku Elbasan
1 vend vakant	ne Qendrat Spitalore, Bashkia Kuçovë	Qarku Berat

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 17 Janar 2018

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Majlinda Bregu nxjerr pa dashje sekretin e saj, që habiti edhe motrat
- Trump lë Melanian dhe djalin të lagen, çadrën e mban për vete
- Deputetin e zë gjumi gjatë debatit për BREX-it në parlament
- Çudit juristja e "La Sapienza"-s: Do doja të isha nusja e Bashës

ENEDA TARIFA është ndarë? Ja kur mund të ketë nisur krisja



DAFY çmend fansat duke prekur "zogun"



Xhensila Pere:



Flet fituesja e "Dance with me":
Ja kujt do t'ia jepja kupën

Do të vija me skena erotike në një film

"Meshkujt s'përdorin trurin para portofolit, janë kthyer në karta krediti"

Intervista

Flet fituesja e "Dance with me": Ja kujt do t'ia jepja kupën

Xhensila Pere:

Do të vija me skena erotike në një film

"Meshkujt s'përdorin trurin para portofolit, janë kthyer në karta krediti"

Ajo është një nga bukuroshet e njohura të ekranit që arriti këtë vit të rrëmbente kupën e "Dance with me Albania" në Tv Klan së bashku me partnerin e saj në kërcim, Trimin. Në një intervistë ekskluzive për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", ish-banorja e "Big Brother 9", Xhensila Pere ka folur për prapaskenat e fitores në këtë konkurs, përse thashethemet e shumta si dhe kë mendon ajo se e meritonte fitoren. Gjithashtu, ish-misi shqiptar na ka zbuluar edhe projektet e saj ambicioze ku nuk ka lënë pa përmendur edhe një dëshirë të saj për të qenë pjesë e kinematografisë, ku e veçanta qëndron se do të vinte me skena erotike. Cili është çmimi që do të pranonte për një set nudo? Zbulojeni në intervistën e mëposhtme.


Pamela Aliaj

Jeni fituesja e "Dance with me", keni marrë pjesë në "Big Brother", jeni njëkohësisht edhe ish. "Miss Shqipëria". Ku synon më tutje Xhensila?

"Sky is the limit". Botën e televizionit e dua, por, gjithashtu, dhe botën e biznesit. Kam akoma shumë projekte, deri kur të mbërrij aty ku dua unë. **Fitorja në "Dance with me" u përfol shumë. Pse disa thanë që ishte e pamërtuar dhe e parashikuar që më parë?**

ua "Opinion" dhe "Dance with me" një javë më vonë. **Nëse do të jepej mundësia të fitonte dikush tjetër kush do të ishte?**

Absolutisht unë dhe Trimin. **Në "Big Brother" jeni përfolur për skenat erotike. Nëse do të ktheheshit pas**



me kë do të donit të kishit marrëdhënie në çift?

Jam nga ata persona që nuk kthehem mbrapsht dhe nuk pendohem për ato që bëj kështu që do ndodhte përsëri e njëjta gjë. **Çfarë të ka ngelur peng nga "Big Brother"?**



Asgjë. Ndoshta pse nuk fitova por ndonjëherë jo gjithçka varet nga ti.

A keni pasur propozime nga televizioni? Ku do t'ju shohim së shpejti?

I vetmi projekt konkret që mund të zbuloj është "Miss Universe Albania" ku punoj për të 4-tin vit radhazi.

A do të guxonit të bënit skena erotike në një film? Pse jo, është një fushë që nuk e kam prekur, kinematografia, por do të më pëlqente të isha pjesë e një filmi.

Për çfarë çmimi do të zvishej Xhensila në një set fotografik?

Duhet ta mendoj mirë këtë pjesë, sepse ka foto nudo, por dhe nudo artistike.

Kështu që duhet menduar pak.

Personazhi që ju duk më interesant në "Dance with me" është..?

Të gjithë personazhet kishin diçka interesante të tyre, por nuk harrohet hu-

A ka një person të rëndësishëm në jetë Xhensila? Përveç familjes, akoma jo. **Cili është propozimi më i çuditshëm nga një mashkull që ju është bërë?**

Meshkujt janë kthyer në qenie të çuditshme dhe mendojnë se gjithçka e kanë një çmim, duke menduar që me lekë mund të arrijnë gjithçka. Dhe harrojnë të përdorin trurin përpara portofolit duke u kthyer në karta krediti dhe jo në një person që të mund ta dash!



mori dhe batutat e Rudinës dhe Drilonit.

Personazhi që do doje të njihje më tepër nga "Big Brother" është..?

Kam marrë aq sa kam dashur nga ata që kam bashkëjetuar aty.





Ata kanë qenë gjithnjë në qendër të medias për krisjen në lidhjen e tyre. Gjithnjë është aluduar koheve të fundit se këngëtarja e njohur Tuna dhe partneri i saj Patris Berisha i kanë dhënë fund lidhjes së tyre. Dyshja simpatike nuk kanë preferuar të flasin për këtë temë edhe pse është monitoruar çdo lëvizje e tyre. Gjithsesi, zërat se ata të dy janë ndarë, çifti i ka hedhur poshtë vetëm me një foto. Tuna ka publikuar në Snapchat një foto me Patrison ku të dy shfaqen pranë njëri-tjetrit, të përqafuar. Tuna shkruan bashkëngjitur fotos, "Nga Times Square me dashuri". Pra, e morët vesh? Ata jo vetëm që nuk janë ndarë, por edhe po shijojnë disa ditë pushime në Amerikë.



S'ka më Tuna dhe Patris? Ky detaj i vërteton të gjitha

Eneda Tarifa është ndarë? Ja kur mund të ketë nisur krisja


Ata kanë qenë për një kohë të gjatë partner në jetë dhe në biznes, an se martesë mes Eneda Tarifës dhe bashkëshortit të saj vazhdon. Erjon Zaloshnjës, ka marrë fund. Rrjetet sociale arrijnë të zbulojnë edhe pa qëllim shumë detaje për jetën personale. Por mund të sjellim 4 shenja që po t'i mendosh mirë mund të dëshmojnë ndarjen e çiftit.: 1. Pavarësisht se një personazh publik, Tarifa dy vitet e fundit nuk ndan shumë foto krah tij. 2. Fotografia e fundit e bashkëshortit, që këngëtarja ka postuar në profilin e saj në "Instagram" daton më 6 maj të 2015-s. Ndërsa krah saj ka bërë një dedikim: "Jeta ime. Një herë vjen Ai". Me herët postimet e saj me bashkëshortin ishin të shpeshta. 3. Prej të kaluar Eneda ndaloi së kënduari për klientët e tij. Me 17 maj është vitesh bashkëpronarë të një klubi të njohur në Tiranë, nga maji i vitit të kaluar Eneda ndaloi së kënduari për klientët e tij. Me 17 maj është postimi i fundit i lokalit ku njoftohet se në skenë do të ngjitet edhe Eneda Tarifa, bashkë me Aleksandër Gjokën, Elton Dedën dhe Erjon Zaloshnjën. 4. Me vonë, më 23 shtator, ajo publikoi foto duke performuar në një prej lokaleve konkurrenente, ku vazhdon ende të këndoje. Shumë detaje arrijmë t'i kuptojmë tani, pasi mësohet për ndarjen e çiftit dhe një prej tyre është edhe fakti se, Eneda nuk u shoqërua nga bashkëshorti në dasmën e Bes Kallakut me Xhensila Myrtezajn.



Plas sherri me ish-banorët e "Big Brother 9". "Mbylle gojën se dukesh më e bukur!"

Edhe pse tashmë nuk janë më pjesë e shtëpisë më të madhe në Shqipëri, "Big Brother", jehona e personazheve të saj vazhdon ende. Këtë herë kanë qenë dy nga banorët e shtëpisë më të famshme në Shqipëri që kanë tërhequr vëmendjen e publikut. Bëhet me njëra-tjetrën për një mashkull. Ka qenë Ambra e para, e cila ka publikuar në "Instagram" një status ku shkruan: "Të kisha shoqe që nga jashtë dhe nuk prisja nga ty këto gjeste, jam e surprizuar nga ti dhe nga aktrimi jot. Bravo, vazhdoni kështu sic jeni, e treguat fytyrën kush jeni". Ndërkohë që Dona ka reaguar shumë shpejt duke iu përgjigjur ish-mikeshës. "Shoqeee??? Fjalë e madhe për t'u thënë, po mbylle gojën se dukesh më e bukur"- ka shkruar Dona. Duket se situata midis dy ish-banoreve është tepër e komplikuar. E kontaktuar për "Gazeta Shqiptare", Dona ka thënë se këtë gjë do ta zgjidhë vetë me Ambrën pa dhënë asnjë deklaratë lidhur me konfliktin. Ende s'dimë shkaku e kësaj "per-plasjeje", por urojmë që vajzat ta zgjidhin shpejt.

Rrjetet sociale janë kthyer në një "sëmundje" jo vetëm për të gjithë njerëzit e thjeshtë, por në një farë mënyre, është kthyer në "mani" edhe për VIP-at. Një mënyrë shumë e mirë marketingu për ta. Nuk mbetet pas as këngëtarja e njohur Dafina Zeqiri, e cila është shumë aktive në rrjetet sociale. Ajo pothuajse çdo ditë ndan imazhe nga përditshmëria e saj. Daffy së fundmi në llogarinë e saj në "Instastory" publikoi një video ku shfaqet duke bërë një gjest me gjuhën e dora i shihet në pjesët intime. Një ditë më parë, Daffy kishte publikuar disa video të njëpasnjëshme ku shihej duke bërë "twerk" e tundte të pasmet. Kujtojmë se Dafina pas një kohe të gjatë qëndrimi në Amerikë, ditë më pas ka qenë në Kosovë ku mbajti disa koncerte.



Daffy çmend fansat duke prekur "zogun"



BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

Majlinda Bregu nxjerr pa dashje sekretin e saj, që habiti edhe motrat

Një postim i fundit i ish-deputetes demokrate ka zbuluar një sekret të saj in që nuk e dinim. Majlinda Bregu i ka 'fobi' qentë. Por kjo foto e saj krahi një qenusheje i ka habitur dhe motrat e saj, të cilat nuk e kanë pritur këtë afrimitet të saj me qentë. Ornela Bregu, moderatorja e njohur që tashmë jeton në Spanjë e ka cilësuar 'revolucion' këtë ndryshim të motrës së saj. Ish-deputetja ka sqaruar se qeni që shohim në foto nuk është i saj, pasi ajo nuk ka një të tillë. Kohët e fundit Bregu është shfaqur shpesh në rrjetet sociale dhe duhet thënë që është mjaft në formë.



m.bregu • Following

ornela_bregu @ ky po që është revolucion

ornela_bregu Tani do të prezantoj me pitbull, doberman, egj, te macat e ndryshme, kane vegantine e vetë

bakubregu Duhet te jete selluh lodër ose cagnolina është deh, se si ka mundesi kjo marrëdhënie

m.bregu @ornela_bregu rroftsh motra. Se ai i joi është ujë

m.bregu @bakubregu shif pergjigjen dhene motres tende

ivaticoo Ace Tico është shkeloz

m.bregu @ivaticoo dal edhe me birin tati!

gimisulku Belli

2018tungramm Lul Basha se besoj te jete se do ishte duke be "mjauuuu"

ledi,lame jepi një lug se gjynaf

2,394 likes



Trump lë Melanian dhe djalin të lagen, çadrën e mban për vete

Nuk është hera e parë që presidenti i SHBA-së Trump vë në siklet bashkëshorten Melania në publik. Hera e fundit ka ndodhur në aeroportin e Palm Beach në një ditë me shi. Donald Trump nuk e ka pritur bashkëshorten e tij kur po ngjijnin shkallët e avionit Air Force One. I vetmi që kishte çadër ishte ai, por nuk e ka vënë ujin në zjarr për bashkëshorten, e cila lagej në shi. Jo vetëm që nuk u shqetësua për Melanian, por as për djalin e tyre 11-vjeçar, Barron.

Deputetin e zë gjumi gjatë debatit për BREX-it në parlament

Një deputet i parlamentit anglez duket se është rehatuar gjatë një debati në Dhomën e Komunave mbi faturën e Brex-it ditën e djeshme. Desmond Suanye nuk ishte në gjendje të mbante sytë hapur teksa kolegu i tij Ken Clarke shpjegonte virtytet e BE-së. Për fat të keq për ish-ministrin, a u kap nga transmetimi televiziv në parlament, teksa ngadalë po shtrihet në karriget e gjelbra. Ndërsa Clarke filloi fjalimin e tij, Suanye dremiti për disa momente.



Çudit juristja e "La Sapienza"-s: Do doja të isha nusja e Bashës

E njohur për batuta dhe deklarata të bujshme, juristja e diplomuar në universitetin e Romës "La Sapienza", Enida Bozheku, ka bërë deklaratën e radhës, që nuk mund të kalojë pa komente. E ftuar në emisionin "Debati në Channel One" të gazetarit Roland Qafoku, pedagogia e jurisprudencës tha: Do doja të isha nusja e Lulzim Bashës për pasurinë 13.1 milionë euro që do marrë në Strasburg. Bozheku e lidhi këtë deklaratë me reformën në drejtësi, me qëndrimin që po mban kryetari i opozitës Lulzim Basha dhe me vendimin e Gjykatës së Strasburgut për kthimin e shumë 13.1 milionë Euro si dëmshpërblim për pallatin e prishur në Vlorë me vendim të qeverisë së Edi Ramës.



VRASJA NE KOSOVE REAGIMET

Atentati ndaj kreut të SDP, flet bashkëshortja: E di kush e ka vrasë

Vritet lideri i serbëve në Mitrovicë, Oliver Ivanović

Haradinaj: Agjentë të FBI për të gjetur vrasësit

Ditën e djeshme medi at serbe raportuan vrasjen me armë zjarri të liderit të partisë SDP, Oliver Ivanović. Sipas raportimeve paraprake, Ivanović është vrasur përpara zyrës së tij në Mitrovicë. E përditshmja serbe "Blic" shkruan se Ivanović u qëllua me katër plumba nga persona të paidentifikuar. Lideri i SDP u dërgua me urgjencë në spital rreth orës 08:15. Avokati i Oliver Ivanović, Nebojsa Vljajic, ka thënë se 64-vjeçari fatkeqësisht nuk mundi të mbijetonte dhe ndërroi jetë në sallën e operacionit. Qeveria e Serbisë ka dënuar ashpër vrasjen e liderit të serbëve në Kosovë, Oliver Ivanović. Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, ka thirrur dje për në orën 18:00, mbledhjen e rregullt të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Këshilli i Sigurisë Kombëtare do të diskutojë për gjendjen e përgjithshme të sigurisë në vend. Kjo mbledhje mbahet pas vrasjes së liderit të Iniciativës Qytetare SDP, Oliver Ivanović. Haradinaj ka thënë se do të kërkojë dhe ndihmën e FBI-së për të gjetur vrasësit e liderit serb në Mitrovicë. Vrasja në Mitrovicë e liderit të serbëve solli dhe ndërprerjen e menjëhershme të procesit të negociatave Prishtinë-Beograd, i cili ishte planifikuar për të rifilluar këtë të martë në Bruksel. Sipas mediave serbe, delegacioni i Serbisë do të kthehet me urgjencë në Beograd pas atentatit të Oliver Ivanovićit. Rifillimi i negociatave mes dy shteteve në kuadër të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian do të niste pas ndërprerjes disa mujore. Ekspertët mjeko-ligjor gjetën 6 plumba në trupin e liderit të partisë SDP, Oliver Ivanović, i cili u vra ditën e djeshme në Mitrovicë. Ekspertët deklaruan se 6 plumbat që u gjetën në trupin e Ivanovićit kanë dalë nga një armë e kalibrit të vogël. Lideri i partisë së serbëve të Kosovës u qëllua për vdekje ditën e martë përpara zyrës së tij në Mitrovicë. 64-vjeçari është gjykuar edhe për disa krime në veri të Mitrovicës. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Shyqerri Sylaj deklaroi se prokuroria ka nisur hetimet për vrasjen e liderit të serbëve të Kosovës, Oliver Ivanović. Për hetimin e kësaj vrasjeje, e cila ndodhi

AMBASADORI AMERIKAN

Ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie ka dënuar vrasjen e politikanit serb në Mitrovicë Oliver Ivanović. Ai thotë se policia duhet të punojë shpejt dhe me profesionalizëm për të zbardhur këtë atentat. Nga ana tjetër, ai i bën thirrje palës kosovare dhe asaj serbe që të mos përdorin retorikë që mund të çojë drejt përshkallëzimit të situatës.



Oliver Ivanović

JETA E OLIVER IVANOVIĆ

Oliver Ivanović u lind në Pejë më 1 prill 1953. Ai u bë kadet në Akademinë Ushtarake të Zagrebinit nga ku u kthye në Kosovë dhe u diplomua në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Mitrovicë. Para luftës ishte president i Klubit të Karatesë "Trepça" në Mitrovicë ndërsa aktivitetin politik e nisi, në vitin 1999, me një kërkesë nga "Rojat e Urës", të cilët e ftuan Ivanovićin për t'i trajnuar si mjeshtër i karatesë. Në 1999 u bë anëtar i Këshillit Kombëtar Serb, SNV, e më vonë president i bordit ekzekutiv. U shkarkua pas dy viteve kur u bënë thirrje serbëve të Kosovës të merrnin pjesë në zgjedhjet në Kosovë. Në vitin 2001, ai nisi krijimin e Trupit Koordinues, organizata zyrtare e qeverisë serbe ndërsa atë vit u zgjodh deputet i Kuvendit të Kosovës nga 2001-2004 nga koalicioni "Kthimi". Oliver Ivanović ishte lider i Partisë "Liri, Demokraci, Drejtësi". Në vitin 2008 Ivanović u bë Sekretar i shtetit në Ministrinë Serbe për Kosovën ndërsa në vitin 2013 kandidoi për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut. Ivanović u arrestua në vitin 2014 për krime lufte në vitin 1999 dhe 2000 në Mitrovicë si i akuzuar për vrasje, dëmtim prone dhe dëbim të shqiptarëve nga veriu i Mitrovicës. Sa ishte në paraburgim, ai hyri në grevë urie në kërkim të mbrojtjes në liri. Dëshmitarët thanë se gjatë luftës e kanë parë me uniformë dhe të armatosur. Ivanović u dënuar për krime lufte të kryera në vitin 1999 me 9 vjet burg ndërsa më vonë rasti ndaj tij është kthyer në rigjykim.

dje në mëngjes në Mitrovicë të veriut, para selisë së partisë së Ivanovićit, tashmë janë angazhuar dy prokurorë të kësaj prokurorie. Pas vrasjes së Oliver Ivanovićit, policia e Kosovës ka ofruar shpërblim prej 10.000 eurosh për çdo qytetar që jep informacione lidhur me autorët e vrasjes. Milena, gruaja e

udhëheqësit të partisë SDP Oliver Ivanović, ishte e tronditur pasi dëgjoji lajmin e tmerrshëm se burri i saj u plagos rëndë, e më pas vdiq. Ajo i tha televizionit Pink, se ata që i vranë burrin nuk do ta kenë lehtë të shpëtojnë. "Unë kam një mesazh për të gjithë ata që kanë bërë këtë dhe është shumë mirë e njohur se kush janë, se kjo nuk

EDI RAMA

Kryeministri Edi Rama e ka cilësuar akt të qëllimshëm për të nxjerrë urrejtjen, vrasjen e liderit serb në Mitrovicë, Oliver Ivanović. Në një reagim në rrjetet sociale, kryeministri Rama ka dënuar këtë krim të rëndë dhe ka shprehur ngushëllimet për familjen e viktimës. "Keqardhje e thellë për tragjedinë e Oliver Ivanović; akt qëllimshëm që nxiti urrejtje e tension. Përpjekjet për dialogun e paqen s'duhen ndalur", thuhet në reagimin e tij.



LULZIM BASHA

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka dënuar atentatin ndaj liderit serb në Mitrovicë, Oliver Ivanović. Përmes një reagimi dënuar mediave, Basha thotë se vrasja e Ivanovićit nuk është vetëm një atentat ndaj tij, por është edhe një atentat ndaj dialogut Kosovë-Serbi. "Vrasja e djeshme e Oliver Ivanović në Mitrovicë, është një akt i pastër kriminal që meriton hetim të plotë dhe ndëshkim nga organet ligjzbatuese në Kosovë", thotë në deklaratën e tij Basha.



do të kalojë lehtë", tha Milena Ivanović. Sulmuesit e panjohur qëlluan në Oliver Ivanović në Mitrovicën Veriore dje në mëngjes në ora 8.30, derisa ai po hynte në zyrë të partisë së tij. Ai hyri pa shenja jete në spitalin Mitrovicës. Ivanović hyri në spital në një gjendje të rëndë dhe mjekët u përpogën ta kthenin atë në jetë, por fat-

keqësisht ai nuk arriti të u shpëtojë plagëve. Milena Ivanović, sapo dëgjoji se burri i saj ishte qëlluar kishite shkruar në spital bashkë me vëllain e Oliverit dhe priti gjithë kohën para sallës së operacionit. Ka genë një infermiere e cila doli nga sala, që i dha lajmin se Ivanović nuk arriti të u mbi-jetojë plagëve.



QEVERIA SERBE DHE PRESIDENTI VUČIĆ

Në një deklaratë për mediat, Marko Gjurić e ka quajtur sulm terrorist vrasjen e politikanit serb në Mitrovicë. "Ky është një tentim dhe sulm për tërë popullin serb dhe është një sulm terrorist e kriminal që duhet dënuar, pavarësisht nëse sulmuesit janë shqiptarë apo serbë", ka thënë Marko Gjurić, shef i zyrës për Kosovën në qeverinë e Serbisë. Ai ka shtuar, gjithashtu, se serbëve në Kosovë gjatë ditëve dhe javëve të fundit u është kërcënuar jeta edhe me luftë. Ndërkohë që, nga ana tjetër, presidenti Vučić e ka dënuar këtë si një akt terrorist.



QEVERIA E KOSOVËS DHE PRESIDENTI HARADINAJ

Qeveria e Kosovës ka dënuar ashpër aktin e vrasjes së politikanit serb duke thënë se kjo sfidon sundimin e ligjit dhe çdo përpjekje për të vendosur rendin në gjithë territorin e Kosovës. "Dhuna është e papranueshme pa marrë parasysh nga kush vjen dhe ndaj kujt drejtohet." Gjithashtu, qeveria në deklaratën e saj fton të gjithë strukturat në gjetjen e kapjen e autorëve. Nga ana tjetër, presidenti Thaçi ka thënë se dënon ashpër vrasjen e liderit të serbëve në Mitrovicë duke u bërë thirrje qytetarëve të të gjitha komuniteteve në veri të vendit të bashkëpunojnë me strukturat e policisë në kapjen e autorit të vrasjes.

BOTIMI STUDIMOR



Ka parë dritën e botimit libri i prof. Bardhyl Demiraj për traditat e hershme shkrimore dhe kulturoro-arsimore të Veriut nga shek. 16-19

Bardhyl Demiraj

Kultura e shkrimit shqip me alfabet latin në 'Arealin Kulturor të Veriut'

Jo rrallë ndodh që një studiues të hasë vështirësi në përzgjedhjen e një titulli të përshtatshëm, kur mendon të mbyllë një monografi, sidomos aso rasash, kur është më se i ndërgjegjshëm që nuk mund të realizojë në plotësinë e vet atë dëshirë e qëllim që desh t'i vinte vetes mirëfilli. Vështirësi shtesë përcjell në këtë paplotësi vetë titulli i kësaj monografie që fokusohet në "Arealin Kulturor të Veriut në shek. XVI-XIX".

Sigurisht që orientimi në dimensionet "kohë" dhe "hapësirë" nuk e lejon lexuesin patjetër të zbërthejë lehtë atë puzzle që bashkëmbart në kohën tonë koncepti 'areal kulturor' në shkencat e ndryshme shoqërore, në mos shumëkuptimësi deri në mosnjohje e vetë konceptit ose nocionit 'kulturë' në përgjithësi. Andaj jemi të detyruar paraprakisht me kumtuar në këto fjalë hyrëse do sqarime të rastit.

Asgjëmangut, në këtë monografi i përmbahemi një koncepti të diferencuar teorik të 'kulturës', duke u kufizuar këtu thjesht dhe vetëm në fushën formimit dhe të produktit intelektual që për periudhën në shqyrtim është përfutur ose ka pasur synim largvajtës mbarëshkrimin e tij në veri të hapësirës kulturoro-etnike shqipfolëse. Parë nga kjo perspektive, diferencimin që bëjmë brenda kësaj hapësire kompakte, pra duke u përqendruar në të ashtuquajturin 'Areal Kulturor të Veriut', e motivojnë për periudhën në fjalë sidomos aktivitetet e ndryshme intelektuale të institucioneve të kulturit që ishin të pranishme në këtë zonë, siç është p.sh. rasti i angazhimit social të klerit katolik që vepronit atëbotë në Provincën administrative-kishtarë të Arbënisë dhe në Arqipeshkvinë e Shkupit.

Fokusimi ynë kryesisht në aktivitetet intelektuale të klerit katolik shqiptar e të huaj në këtë periudhë sendërton në domethënie e vet largvajtëse shi këtë koncept relativ të 'Arealit Kulturor të Veriut', meqë pikërisht këtu e përgjatë kësaj periudhe zë rrënjë e hedh shtat edhe ajo traditë e shkrimit shqip me alfabet latin, e cila ratifikohet në formën e vet përfundimtare me një kod të ri në Kongresin e Manastirit (1908), bashkë me këtë alfabet, madje duke e përdorur atë edhe në komunikimin ndër-institucional me Kurinë e Shenjtë (D/XXII) ase me organet e pushtetit vendor (D/XXIV).

Duke u përmbytur kësaj premise metodike lejohemi së fundi të syzohim si faktor integruar të këtij areali për periudhën në fjalë bashkë me qytetin e Shkodrës si qendra kryesore urbane në gjysmën e dytë të shek. XIX, e cila falë angazhimit social të klerit katolik dhe të organeve të Protektoratit të Kulturit vjen e shndërrohet natyrshëm në një vatrë të parë dhe të mirëfilltë goftë të formimit intelektual ashtu edhe të diskutit shkencor-albanologjik brenda hapësirës kompakte shqipfolëse. (A/IV)



Në foto: Prof. Bardhyl Demiraj

Botimi i ri, një kolazh prej 29 studimesh që u shpërfillën ose u anashkalon me një mentalitet antikombëtar

Përmblohdhëm kështu thuket, përpos objektit edhe qëllimin, dhe motivet që na nxitën t'i japim formë kësaj monografie, e cila rrok në vetvete një kolazh prej 29 studimesh, të organizuara në 28 krerë, përkatësisht në katër rubrika të veçanta.

Ndër to, rubrika e parë ngërthen katër "vatra të formimit intelektual" me destinacion (edhe) Verium katolik shqiptar (A/I-IV: Loreto, Romë, Fermo dhe Shkupëri), ndërsa në rubrikën e dytë jemi fokusuar në do portretizime të asaj elite intelektuale që ka qenë aktive këtu gjatë periudhës në shqyrtim (BN-XVII - "takime me elitën"). Jemi gjithsesi më se të ndërgjegjshëm sidomos për paplotësinë e kësaj rubrike, meqë jemi kufizuar në vetëm 13 emra personalitetesh që i takojnë pasur-

Demiraj: Hiqni dorë nga paragjykimi i pavarlerë, duke e cilësuar këtë trashëgimi në fund të shek. XIX si zhvillim regresiv

elite, madje edhe sikur t'i përkushtojë kësaj tematike gjithë jetën e tij aktive në profesion dhe atë të shëndetshme në pension.

Këtë rrethanë jemi rrekrutuar ta bëjmë më se të dukshme dhe të prekshme në rubrikën e tretë, ku shpresojmë të sensibilizojmë sado pak lexuesin për 'mjerimin e madhështisë' që përjeton ndërkohë jeta intelektuale shqiptare (C/XVII-XX - "kujtesa kolektive në 'tranzicion'").

Në këtë rubrikë vihet theksi fort tek ato pasoja tejet negative që vuan sot e gjithë ditën formimi intelektual-albanologjik prej orientimit të dikurshëm ideologjik për krijimin e njeriut të ri intelektual me kujtesë historike-kolektive të shpëlarë (damnatio memoriae).

Sigurisht që kjo rubrikë do të

II - "prurje të elitës") ngërthen si e tillë ndërhyrje të natyrës filologjike me kornizat paratekstuale përkatëse për tetë tekste si prurje thelbësore në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip me alfabet latin përgjatë shek. XVII-XIX. Ndër to feksion edhe regjistrimet me të hershme të folklorit muzikor me notacionin përkatës (D/XXI). Këto tekste i nënshtrohen për të parën here hulumtimit të mirëfilltë historik-kulturor, ekdotik dhe atij gjuhësor-normativ, bashkë me parametrate të filologjisë moderne. Një synim i dytë, por aspak dytësor, i autorit në këtë rubrikë është të ndjekë hap pas hapi prurjet në kulturën e shkrimit shqip me alfabet latin në 'Arealin Kulturor të Veriut', e cila arriti një pikë kulmore në gjysmën e dytë të shek. XIX, kur përjetojmë një normë të ngulitur të shqipes së shkruar mbi bazën e së folmes së Shkodrës si sendërtim i ndryshimit të paradigmeve të vetë kësaj kulture, e cila i drejtohet tashmë formimit shkollor-intelektual të masës së thjeshtë qytetare (D/XXVI; D/XXVIII).

Është pikërisht kjo fazë e re zhvillimi në 'Arealin Kulturor të Veriut' që mbetet ende për t'u hulumtuar, krehur, sistematizuar e klasifikuar ashtu siç duhet. Veçse për këtë do hequr së pari mendje e dorë nga ai paragjykim sa i pavarlerë aq edhe i pafan që i ka parë e i sheh këto prurje me syrin e njerësisht, duke e cilësuar këtë trashëgimi në fund të shek. XIX si zhvillim regresiv drejt krahnorizimit ekstrem e kundërpërdorimit, bashkë me një periudhë kur triumfonte Lëvizja kulturoro-ideologjike e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kush e shpërfill ose i anashkalon këtij mentaliteti antikombëtar, përjeton dhe përcjell ndryshe edhe atë kumt fatum të At Anton Xanonit, kur shkruan në letër të bardhë menjëherë pas përfundimit të Kongresit të Manastirit: "Udhë mar i kioft alfabetit t'vietër e na rmoft i riu!" (LZJK 1909, nr. 337) Sigurisht që ky personalitet i kulturës intelektuale shqiptare e kishte fjalën për kodin e ri të shkrimit të shqipes me alfabet latin, siç e mësojmë dhe e përdorim të unifikuar sot e gjithë ditën. Parë nga kjo perspektive, edhe ai koncept relativ që feks në titullin e kësaj monografie: "Areali Kulturor i Veriut në shek. XVI-XIX", fiton gjithnjë e më shumë tumirje dhe kuptim.



Në foto: Kopertina e librit

ishtë krejt e tepërt, në rast se në botimet e fundit të natyrës akademike (FESH, bl. I-III, Tiranë 2008/9) lexuesi i thjeshtë nuk do të përballë me procesin e dhunshëm të 'emilimizimit' të enciklopedisë zyrtare (C/XVIII). Bëjmë fjalë këtu për atë dukuri sui generis në jetën intelektuale shqiptare pas kthesës historike demokratike (1991), një dukuri kjo që ngjiz në unison ndjesinë reale të 'kompleksit të inferioritetit' me atë irracionale të 'delirit të madhështisë' (laudatio funebris) që përjetonin dhe përjetojnë ende shumë e shumë (ish-) funksionarë intelektualë që drejtonin dikur institucione të ndryshme të formimit kulturor-intelektual dhe shkencor-universitar në vend.

Rubrika e fundit (D/XXI-XXVI)

TRASHEGIMIA



Kishat e Voskopojes në listë rreziku? Ja përgjigjja e Ministrisë së Kulturës!

Fatmira Nikolli

12 kisha të Voskopojes dhe Vithkuqit janë nominuar nga organizata "The past for the Future" si kisha në rrezik. Sipas organizatës në fjalë objektet janë të neglizhuara tërësisht dhe nën menaxhimin e Institutit të Monumenteve. Dëmet janë cilësuar të ardhura nga hyrja e ujit në çati dhe nga dritaret, ndërsa flitet për dëme në afreske. Organizata "The past for the future" ka kërkuar që këto kisha të futen në listën e objekteve të rrezikuara të Europa Nostrës për vitin 2018. Në të njëjtën listë, organizata kërkon të fusë edhe Gjirokastrën.

Duket se i menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i Ministrisë së Kulturës. Kjo e fundit përmes postimeve të ndryshme, ka bërë me dije ndërhyrjet në kishat e Voskopojes dhe restaurimet e bëra së fundmi sikundër projektet e realizuara dhe ato të miratuara për Gjirokastrën. Ministria hedh dritë pikërisht mbi investimet që kanë nxjerrë nga rreziku kishat në atë zonë, që sidomos në dy vitet e fundit ka pasur një vëmendje të madhe duke tërhequr fonde të konsiderueshme.

REAGIMI I MINISTRISË

Në fshatit turistik Voskopoje ka përfunduar projekti për restaurimin e strukturave në kishën e Shën Nikollës, Shën Marisë, manastiri i Shën Prodhomit dhe kisha e Shën Ilisë së njoftuar Ministria e Kulturës.

"Me një ndërhyrje me mbi 12 milionë lekë të reja kemi nxjerrë këto kisha nga rreziku. Korça është një nga hambarët e turizmit kulturor dhe itinerari i rrugës së besimit në Korçë e ka pikën kulmore në Voskopoje, për të vazhduar me kantieret në Dhërmi, Vuno, Gjirokastrë", pat deklaruar ministria Mirela Kumbaro nga Voskopoja.

Ministria bën me dije se Kisha e Shën Nikollës, Voskopoje ka rëndësi të veçantë, si në aspektin historik dhe atë arkitektonik si dhe ka vlerë të çmuara për pikturën murale dhe artin e dekorit në interior. Restaurimi i kryer kon-

siston në ndërhyrjet për përmirësime dhe për ruajtjen, rinovimin e objektit në drejtim të kohëzgjatjes së tij si monument. Përveç arkitekturës në këtë projekt, më vonë do të ketë dhe trajtime të pikturave murale në pjesët e tyre të brendshme dhe të jashtme. Të dyja ndërhyrjet do të rritin vlerën e objektit dhe njëkohësisht pritet që të rritet vizitueshmëria. Investimi për rehabilitimin e

"Investimi për rehabilitimin e qendrës historike të Voskopojes kap vlerën 365 milionë lekë të reja"

formon qendrën kompozicionale të manastirit. Sipas mbishkrimit të gdhendur në një pllakë mermeri, të vendosur mbi portën e hyrjes ndërtimi i kishës është

funduar para disa muajsh na jep sot këtë pamje të plotë.

GJIROKASTRA

Vetëm dy ditë më parë u bë me dije se 18 banesa në qytetin e Gjirokastrës do t'i nënshtrohen restaurimit. Vendimi është marrë në mbledhjen e fundit të KKR-së, e cila miratoi projektet restauruese të hartuara nga IMK dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës në Gjirokastrë në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Në listën e shtëpive që do të restaurohen janë edhe ato më të rrezikuara si banesa e Kabilatëve, banesa Çano, Lolomani, Skënduli etj, të cilat do t'i nënshtrohen një restaurimi tërësor sipas projekteve specifike për secilin prej tyre.

Një seri e banesave që do të restaurohen të cilat janë: banesa Kabilatët; Zeko; Lolomani; Batha; Skënduli; Kokobobo; Gurgai; Ish-Radio dhe banesa Çano janë pjesë e projektit

të trashëgimisë materiale, për të evidencuar dhe konservuar vlerat historike dhe artistike të tyre, bazuar në modelin e shtëpisë së Kadarese.

Përveç banesave që janë pjesë e projektit "Shtëpitë e Shkrimtarëve", KKR miratoi edhe projektet e restaurimit dhe rehabilitimit të fasadave në lagjen Hazmurat dhe Pazari i Vjetër në Gjirokastrë për banesat, "Avdi Bozgo", "Familja Aliko", "Zapanaja Alimatët", "Pajtim Ahmeti", "Hirov Spahiu", "Vëllazëria Dudumi", "Kamberi dhe Krongo", "Familjes Jaupi", "Familjes e Sevo Caro".

Ndërhyrjet restauruese të parashikuara në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës. Në listën e shtëpive që do të restaurohen janë edhe ato më të rrezikuara si banesa e Kabilatëve, banesa Çano, Lolomani, Skënduli etj, të cilat do t'i nënshtrohen një restaurimi tërësor sipas projekteve specifike për secilin prej tyre. Një seri e banesave që do të restaurohen të cilat janë: banesa Kabilatët; Zeko; Lolomani; Batha; Skënduli; Kokobobo; Gurgai; Ish-Radio dhe banesa Çano janë pjesë e projektit

qendrës historike të Voskopojes kap vlerën 365 milionë lekë të reja dhe, përveç rikonstruksionit të 4 kishave, përfshin edhe investime në infrastrukturën rrugore të fshatit.

Në Voskopoje po ecën me ritme të shpejta një nga investimet më të rëndësishme të qeverisë shqiptare, me synimin që ta kthejë këtë qytezë në një pikë turistike të vizitueshme për 12 muaj. Projekti përfshin rikonstruksionin e plotë të rrugëve, qendrës, sistemit të ndriçimit dhe restaurimin e plotë të 4 kishave të shpallura Monument Kulture.

Manastiri i Shën Prodhomit ndodhet në anën veriore të Voskopojes. Është ndërtuar në një pozitë të bukur natyrore, në mes të një pylli pishash dhe me pamje të gjerë të peizazhit rrethues. Kisha, e ngritur në mes të oborrit,



të bërë në vitin 1632, ndërsa pikturimi në vitin 1659. Gjendja e konakëve ka qenë e degraduar dhe rrezikonte të shembej. Ndërhyrja restauruese e për-

"Shtëpitë e shkrimtarëve", një projekt i cili parashikon ndërhyrje në strukturën e brendshme dhe të jashtme të këtyre banesave

Banesa Çano ndodhet brenda Qendrës Historike të qytetit të Gjirokastrës ka një vlerë shumë të madhe për kompozimin e saj tepër të thjeshtë, që i përket variantit të pazhvilluar me dy krahë. Gjatë viteve, kjo banesë ka pësuar ndryshime të shumta në katet e banuara duke zvogëluar ambientet fillestare, për të rritur numrin e tyre dhe për pasojë ka humbur shumë nga elementet origjinale të saj.

Opinion / Ditës

Vrasja e Oliver Ivanoviçit, shenjë e frymës së ndarjes

Nga Baton Haxhiu

(Vijon nga faqja e parë)

... personalisht për më shumë se 20 vite.

Kemi dialoguar dhe kemi pasur mos pajttime serioze. Por, ai ka qenë i qartë në kërkesat e tij për serbët e Kosovës.

Oliveri e ka ditur saktë se çfarë krimesh ka bërë Serbia me shqiptarët dhe ka qenë i qartë se ajo ka qenë koha më e dhunshme.

Mirëpo, ana e tmerrshme e këtij problemi është se - ndonëse të gjithë ne jemi të bindur për këtë - për 20 vite nuk dimë të propozojmë një zgjidhje.

Pse është vrarë Oliveri dhe pse s'më bëhet të shkruaj më gjatë?

Ai sigurisht nuk është vrarë për gjyqin e tij për krime lufte. Më herët kishte deklaruar për revistën NIN se burgun e kishte nga serbët dhe jo nga shqiptarët.

Oliveri ka qenë kundër idesë për ndarjen e Kosovës.

Zëri i serbëve kosovarë ndaj të cilit qeverisja aktuale në Beograd nuk ka pasur pushtet dhe ndikim.

Ishte kundër ndarjes për shkak të qëndrimit se brenda në Kosovë ka më shumë serbë se sa që ka në veri.

Një ditë, ndoshta, do të dihen vrasësit. Ata edhe do të mund të eliminoohen nga vetë porositësit e tyre.

Kjo luftë që ende vazhdon është bërë e neveritshme për faktin se ne të gjithë në Ballkan po lejojmë që të udhëhiqemi nga ata që kanë dëshirë të vrasin.

Fatin e Oliverit, jo me vrasje fizike, por politike, e kanë përjetuar të gjithë serbët lokalë që ishin në parlamentin e Kosovës.

Ata u eliminuan politikisht që Aleksandar Vuçiç ta ketë më të lehtë dialogun dhe ta mbajë nën kontroll të gjithë procesin. Vuçiç ka dashur që vetë ta udhëheqë dialogun dhe të ketë përkrahje nga ndërkombëtarët.

Dhe këtë eliminim politik të serbëve lokalë e ka bërë me përkrahjen e madhe të BE-së, SHBA-së dhe Rusisë.

Një zë tjetër i ngjashëm me Oliver Ivanoviçin është peshkopi Teodosije.

Edhe ai është kundër ndarjes dhe i takon vijës së Sava Janjic.

Edhe Teodosije nuk do jetë më në Kosovë. Do e shpërngulin larg, në Australi.

Çfarë porositë është kjo?

Fryma e ndarjes është forcuar. Oliver Ivanoviç është viktimja e parë e kësaj kauze, e cila aminin e ka edhe jashtë Kosovës dhe Serbisë.

Edhe Teodosije nuk do jetë më në Kosovë. Do e shpërngulin larg, në Australi.

Çfarë porositë është kjo?

Fryma e ndarjes është forcuar. Oliver Ivanoviç është viktimja e parë e kësaj kauze, e cila aminin e ka edhe jashtë Kosovës dhe Serbisë.



HOROSKOPI

DASHI

Do t'i ndani idetë tuaja me të tjerët dhe do të merrni miratime nga ata që i vlerësoni. Dhe mos u shqetësoni, askush nuk do të qahet, nëse lini mënjanë ndonjë hollësi me pak rëndësi. Miqësi për t'i forcur apo për t'i rizbuluar: ndoshta pas një kontakti fillestar virtual, një takim real!

DEMI

I keni besuar një personi që e keni njohu së fundmi, dhe tashmë jeni të zhgënjyer nga sjellja e tij jo shumë korrekte. Planetët nuk janë të favorshëm ndaj jush. Mos e ndërlikoni më tej situatën. Mos e prishni ditën dhe pranoi çdo pasojë.

BINJAKET

Falë pozicionit të favorshëm të Neptunit, të tjerët do ju ndihmojnë në punët e shtëpisë, kështu që do arri të keni pak kohë të lirë për vetë. Jeni gjithmonë të gatshëm të ndihmoni të tjerët dhe asnjëri nuk do refuzojë tju japë një ndihmë të vogël, nëse ja kërkon tju.

GAFORJA

Projektet më të rëndësime fillojnë mbarë, edhe falë bashkëveprimit të Mërkurit me Neptunin si edhe mundësisë që keni për t'i shtuar talentet që keni. Nuk keni probleme t'u tregoni të tjerëve se keni të drejtë, ja pse do t'ju ndjekin pa u sturcur.

LUANI

Pozicionimi i Saturnit ju pengon, por ndërkaq ndërhyrje e Neptunit nuk mund të mos ndodhte në një moment më të mirë, për ju. Do të tejkaloni çdo lloj pengese. Nëse një çështje po ndërlikon ekzistencën prej disa kohësh, tani me në fund gjithçka zhblikohet.

VIRGJERESHA

Disa angazhime të rëndësime nuk ju lënë kohë që t'i realizoni ashtu si dëshironi. Fatkeqësisht, megjithatë, askush nuk duket i gatshëm t'ju ndihmojë. Do t'i kryeni detyrat e juaja edhe të vetëm, dhe në mënyrën më të mirë të mundshme.

PESHORJA

Energjia e Jupiterit do t'ju nevojitet së tepërmi në botën e sipërmarrjes. Do t'ju ndihmojë, gjithashtu, të kanalizoni më mirë energjitë tuaja, në mënyrë që të ngriheni. Durimi shpërblehet, por në këtë rast nevojitet mbi të gjitha vullneti, që sidoqoftë nuk ju mungon!

AKREPI

Planetët do t'ju shtyjë drejt aventurës dhe ndryshimeve të papritura. Por para se të lëni sigurnë dhe pasigurinë, mendohuni dy herë. Disa hapa të ndërmarrja mund t'ju çojnë që të bëni disa zgjedhje të rëndësishme, që do të përfundojnë duke ju ndryshuar jetën.

SHIGJETARI

Për faj të lidhje midis Marsit dhe Venusit, sigurnitë e juaja do të dalin së janë këshilltëlla broi rëre, mbi të cilat nuk mund të keni më besim. Është më mirë të ecni me ngadalë për të mos u rrezuar, gjë që nuk mund t'ia lejon vetes në këto kohë.

BRICJAPI

Nëse në të kaluarën nuk ia keni dalë të shfrytëzoni të gjithë potencialin e një situatë shumë premtuese. Tashmë bashkëveprimi i planetëve do t'ua japi mundësinë. Mos rini duarkryq, sepse tani është momenti që të përsheptoni për të arritur një objektiv të dëshiruar.

UJORI

Sot do të përjetoni një krijimtari të madhe. Jeni të palodhshëm, të aftë për të punuar pa ndaluar. Nganjëherë, megjithatë, nuk e kuptoni që e tejkaloni masën. Një ofertë pune duket shumë premtuese. Çfarë prisni për ta pranuar? Mos humbni kohë!

PESHQIT

Shfrytëzoni bashkëveprimin e Diellit me Hënë për të zmahuar dhuntitë tuaja dhe të përdorni çdo mënyrë për të vënë në vijë punët e juaja. Nganjëherë nuk duhet të lodhëni shumë për të rënë në sy, mjafton të zgjidhni me kujdes mundësinë më të mirë.

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Te gjitha te rejat nga jeta vipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

Opinion *i* Ditës

PËR NJË KËSHILL MBARËKOMBËTAR PËR VITIN E SKËNDERBEUT

Nga Rexhep Qosja

(Vijon nga faqja e parë)

... të posaçëm për organizimin dhe përrurimin e këtij viti.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar njëkohësisht nga qytetarët që të japin ide, sugjerime e propozime për kalendarin e aktiviteteve që do të mbahen gjatë këtij viti.

Edhe pse me vonesë, po i përgjigjem tash kësaj kërkesë të kryeministrit.

Viti 2018, si vit i Skënderbeut, është vit i figurës më të madhe, më të rëndësishme e më largpamëse në historinë e popullit shqiptar.

Është ky vit që do të shënohet në Shqipërinë shtetërore, në Kosovë, në Maqedoni dhe kudo ka tjetër shqiptarë në Ballkan dhe në botë.

Është ky vit që do të shënohet prej institucioneve shtetërore, prej institucioneve shkencore, prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, prej Akademisë së Shkencave e të Arteve të Kosovës, prej lidhjeve e shoqatave të shkrimtarëve, të krijuesve të tjerë të arteve, prej shoqatave të ndryshme kulturore, prej partive e prej grupeve të ndryshme partiake e jo-partiake.

Është ky vit që do të shënohet në mënyra të ndryshme: me akademi shtetërore, me akademi shkencore, me manifestime e me veprimtari politike, kulturore, argëtuese. E të tjera. E të tjera.


Mund të besohet se gjatë gjithë këtyre akademive, manifestimeve e veprimtarive të tjera shënuese do të sillen të dhëna të reja, shqyrtime të reja, gjykime e vlerësime të reja shkencore, historike, kulturore, politike për figurën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, për kohën e tij, për trajtimin e tij të deritashëm në historiografinë, në letërsinë e në artet kombëtare dhe në artet evropiane e botërore.

Mund të pritet që në gjithë këto manifestime e veprimtari shkencore, kulturore, artistike, politike, shtetërore, argëtuese të ketë edhe shumë retorikë e patos.

Por, mund të besohet se gjatë gjithë këtyre manifestimeve e veprimtarive shkencore, politike, shtetërore, kulturore e argëtuese do të prodhohen edhe kic mendime, kic gjykime e kic vlerësime.

Mund të pritet gjithashtu që në të gjitha këto manifestime e veprimtari do të prodhohet edhe jo pak kic atdhetarizëm.

Për të qenë Viti i Skënderbeut i shënuar më mirë e më suksesshëm, në pikëpamje shkencore, kulturore, artistike, politike, shtetërore më dinjitetshëm e më ndikueshëm jo vetëm në përpjesëtime gjithëkombëtare e, pse jo edhe më gjerë, mendoj se duhet të formohet Këshilli i quajtur Këshilli Mbarëkombëtar për Vitin e Skënderbeut, i cili do të merret me "organizimin dhe përrurimin e këtij viti" në të gjithë hapësirën shqiptare e në diasporë.



Nuk është vonë për krijimin e këtij Këshilli Mbarëkombëtar, i cili do të përbëhet prej përfaqësuesve politikë e shtetërorë, prej përfaqësuesve të organizatave qytetare, prej historianëve, prej shkrimtarëve e krijuesve të arteve të tjera, prej publicistëve të Shqipërisë shtetërore, të Kosovës, të



Për vitin kushtuar një figure madhore historike, siç është Gjergj Kastrioti Skënderbeu, doemos duhet të ketë edhe një Këshill të tillë Mbarëkombëtar

Maqedonisë, të Malit të Zi, të Luglinës së Preshevës, të arbëreshëve të Italisë dhe shqiptarëve të diasporës evropiane e amerikane.

Për vitin kushtuar një figure madhore historike, mbarëkombëtare e gjithëkohore, siç është Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i cili në jetën e vet bashkoi idenë e madhe mbarëkombëtare dhe shpatën për mbrojtjen dhe sendërtimin e saj, doemos duhet të ketë edhe një Këshill i tillë Mbarëkombëtar. Apo jo?

***Prishtinë,
15 janar 2018**

SITUATA

Dopingu, federata e shtangës bën të habiturën

Pas lajmit të marrë nga Federata Botërore e Peshëngritjes se Romela Begaj ka rezultuar pozitive në testin e parë antidoping, i menjëhershëm ka qenë edhe reagimi i trajnerit dhe njëkohësisht bashkëshorti i saj, Gazmend Hakcani, i cili ka theksuar se Romela Begaj është e pastër dhe se janë në pritje të testit B, i cili do të hapet në Montreal të Kandasë. Ky lajm u konfirmua dhe nga drejtuesit e Federatës Sh-



qiptare të Peshëngritjes, të cilët tashmë janë në pritje të përgjigjes nga testi B. Presidenti Gjozaj dhe sekret-

tari i përgjithshëm i FSHP, Agron Haxhihyseni kanë shprehur befasinë nga ky lajm. Pavarësisht se testi B nuk është premtues për të ndryshuar rezultatin, të gjithë shprejnë që dy medaljet e fituara nga Romela Begaj të jenë të pastra. Peshëngritja shqiptare rezultoi pozitive me substancën e Stanozolit dhe për kohësisht është pezulluar nga të gjithë aktivitetet.

PORTIERI DREJT ANGLISË

Strakosha i mahnit të gjithë, mediat ia sugjerojnë Liverpoolit

Liverpuli duket se e ka emergjencë gjetjen e një portieri të ri, pasi dy portierët aktualë nuk ofrojnë siguri. Këtë gjë e dinë më së miri edhe tifozët, edhe mediat lidhur me klubin. Njëra ndër to, "Liverpool Echo", e cila është një media e certifikuar pranë klubit të Liverpoolit ka shkruar një artikull në faqen e saj, ku u sugjeron drejtuesve disa nga portierët më të mirë të momentit, ndër të cilët Liverpool mund të zgjedhë. Portierët variojnë nga ata me eksperiencë si



Jan Oblak deri ata më të rinjtë. Midis të përçezdhurve është edhe portieri i Kombëtares sonë, Thomas Strakosha. Ja

çfarë shkruan për shqiptarin kjo media. Shqiptari është pak i njohur, por ka bërë një mirë me Lacion këtë sezon, duke pasur statistika mjaft të mira. 22-vjeçari i lindur në Athinë ka pritur 53 krosa brenda zonës së tij, me një saktësi prej 100%. Por më e rëndësishmja, ai ka pësuar vetëm 24 gola në 19 ndeshje, duke e mbajtur portën 5 herë të paprekur. Ai vetëm mund të për mirësohet në të ardhmen.

E njëjta sportiste, e njëjta federatë, e njëjta substancë. Stanozololi zhbën suksesin e madh

Sërish doping, sërish Romela!

Peshëngritja mbulohet nga turpi

Federata hesht, faji kryesor është mbi të



Jeton Selimi

Pas triumfit vjen një tjetër skandal që trondit peshëngritjen shqiptare. Pritet vetëm zyrtarizimi, por Romela Begaj ka dështuar në testet antidoping në Botërorin 2017 të zhvilluar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku ajo u shpall kampione e botës në shqepje dhe nënkampione e botës në dygarësh. Burime të "News 24" bëjnë të ditur se prej disa ditësh ka mbërritur përgjigja e testit A, pozitiv në përdorimin e një substance të ndaluar. Dyskohet se është Stanozoloni, e njëjta substancë që e ndëshkoi Romela Begajn edhe në vitin 2014. Atëherë sportistja shqiptare u pezullua për dy vjet nga të gjitha aktivitetet. Romela Begaj është pezulluar për kohësisht, ndërsa ka të drejtë të kërkojë përsëritjen e testit antidoping, ose siç quhet Testi B dhe nëse ky i fundit konfirmon pozitivitetin e peshëngritjes, atëherë ajo përballet me një pezullim permanent. Jo vetëm kaq. Pasi për shkak të përsëritjes së rasteve të dopingut, sanksione mund të ketë edhe vetë Federata Shqiptare e Peshëngritjes, e cila në mars do të organizon të dhe Kampionatin Europian të Peshëngritjes për të rritur.

DOPINGU, NJË HISTORI E TRISHË

Peshëngritja është sporti që i ka sjellë më shumë medalje Shqipërisë, por edhe ai

që e ka turpëruar më shumë me skandalet e dopingut. Romela Begaj është e fundit që dyshohet se ka përdorur substanca të ndaluara në sport gjatë Botërorit të fundit, por historia nis që në fillimet e viteve '90. Në atë kohë, mungesa e informacionit për listën e substancave të ndaluara që përditesohet shpesh, është një alibi e fortë, ndërsa lajmet me vështirësi shkonin deri tek opinionin publik. Por në vitet 2000 dopingu u bë shqetësues dhe solli tronditjet më të mëdha në peshëngritjen shqiptare. Në vitin 2007 u regjistruan rastet dhe dënimet e bujshme. Tre



peshëngritësit Isa Bala, Mirjan Lozi dhe Fetije Kasa u gjetën pozitivë në testet antidoping dhe u pezulluan nga të gjitha aktivitetet. Viti

2012 ishte më i errët. Erkan Qerimaj u pezullua për një vit, pasi ishte shpallur kampion Europe, duke humbur edhe medaljen e artë. Po

në atë vit, nga Lojërat Olimpikë të Londrës u pezulluan Hysen Pula dhe Ilirian Suli, që dështuan në testet përpara turneut më të rëndësishëm të sportit botëror. Peshëngritja u trondit sërish në vitin 2014, kur pas Botërorit në Kazakistan, tre sportistë të tjerë rezultuan pozitivë. Vetë Romela Begaj, Daniel Godeli dhe sërish Hysen Pula u pezulluan nga të gjitha turnetë, ndërsa kjo ngjarje u vesh me një teori konspirative, ku në qendër të saj ishte Luan Shabani, ish-peshëngritësi që u kujdes për stërvitjen e sportistëve shqiptarë në Athinë.

SHOQATAT SPORTIVE

Idrizi padit në prokurori presidentin Duka



Ditën e djeshme administratori i klubit "Flamurtari", Sinan Idrizi, ka dorëzuar në prokurori një kallëzim penal për kreun e FSHF-së, Armand Duka, për shkak të shogatave fantazmë të përgjithshme në gjykatë. "Kemi bërë një kallëzim penal për shoqatat e paligjshme, pas njoftimit në media për një situatë të tillë. Janë 12 shoqatat të përgjithshme në gjykatë, anëtarë të asamblesë së FSHF-së. Tani fjalën e ka prokuroria. Ky është hapi i parë, ka të tjerë në vazhdim. Flasin për një futboll të pastër, që nuk ka administratë të pastër", - tha Idrizi pas kallëzimit të bërë në prokurori.

TALENTI KA MERKATO

Sirena italiane për Abazajn, Kievo interesohet për sulmuesin

Kristal Abazaj mund të mos shkelë fare në Korçë, pasi Serie A po thërret emrin e tij. Ylli i Luftëtarit dhe i Kombëtares U-21 po ndrin fort në Kategorinë Superiore dhe shkëlqimi i tij duket se ka kaluar Adriatikut, duke bërë që klube të elitës së futbollit italian të kthejnë kokën nga Gjirokastra. Lajmi konfirmohet nga e përditshmeja sportive më e madhe në Apenine, "La Gazzetta Dello Sport", e cila shkruan se Kievo, Verona ka shfaqur interes për Kristal Abazajn. Vetë Abazaj së fundmi ka konfirmuar se ka firmosur një kontratë me Skënderbeun, për t'u bashkuar me bardhekuqtë vetëm në verë, pasi të ketë përmbyshur detyrimet e tij me Luftëtarin. Por ky lajm mund të hapë dritare të reja për karrierën e futbollistit të talentuar, që natyrisht nuk do të mund ta rrefuzonte një mundësi të tillë dhe rastin për të shfaqur vlerat e tij në një skenë më rëndësi të madhe në futbollin botëror. Gjithsesi, momentalisht Kievo është ende në fazën e vëzhgimit të rastit, por nuk përjashtohet mundësia që të shfaqë një ofertë konkrete në ditët në vijim.



MERKATO

KUKËSI, PRANË AKORDIT ME NJË KROAT

Dhe pse ka afruar lojtarë, Shkodrën, Zderic, Dzaria, Le Dilon dhe Ymerajn, tekniku Pakull dëshiron edhe një futbollist tjetër me tipare sulmuese. Bëhet fjalë për mesfushorin shtatshtkurter, Dejan Glavica, i cili është pjesë e ekipit kroat të Varazdin. 26-vjeçari shikohet si një opsion i mirë për mesfushën dhe për sulmin në krah të djathtë ndaj drejtuesit e Kukësit hyjnë në garë për ta afruar atë.

PARTIZANI PO BISEDON ME HAXHIMUSËN

Njëri ndër futbollistët më të mirë të Gjilanit, Betim Haxhimusa, duket se ka karrierën do ta vazhdojë te Partizani. Ky është lajmi që ka përcjellë dje portali kosovar "Sporti24". Tregu kosovar mbetet më i preferuari për të kuqtë, ku për janarin ishin preferuar disa lojtarë. Betim Haxhimusa është lakuar prej ditësh, ku përveç tij, nga skuadra e Gjilanit u përfol edhe mbrojtësi Armand Thaçi.

LUGANO ZYRTARIZON MBROJTËSIN SHQIPTAR

Mbrojtësi me origjinë shqiptare, Jetmir Krasniqi është zyrtarisht lojtar i Luganos. 23-vjeçari, i cili luan në krahun e djathtë, ka nënshtuar për 2 vjet e gjysmë me skuadrën zvicerane. Në të kaluarën Krasniqi ka mbajtur veshur fanellën e Lozanës, Le Mont dhe Kiaso, ku në total është aktivizuar 75 ndeshje. Shqiptari i Kosovës është pjesë e moshave të Zvicrës. Ai është aktivizuar 3 ndeshje me U20 dhe 1 në U21.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

